FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.45 | 21 prill | 2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 255 datë 25.3.2010	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Konferencës së Hagës "Për marrjen e provave jashtë shtetit në çështjet civile ose tregtare".....	1679
Ligj nr.10 256 datë 25.3.2010	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941 dhe për ndërtimin e vendprehjes për ta brenda territorit të Republikës së Shqipërisë"	1688
Ligj nr.10 257 datë 25.3.2010	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës"	1692
Ligj nr.10 258 datë 25.3.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit"	1698
Ligj nr.10 259 datë 1.4.2010	Për ratifikimin e "Marrëveshjes financiare shtesë për marrëveshjen e projektit të financimit, datë 6.2.2007, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë e ndërmarrjes së ujësjellës-kanalizimeve, Pogradec dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW) për programin e mbrojtjes mjedisore të liqenit të Ohrit "Kanalizimet, Pogradec II""	1700
Ligj nr.10 260 datë 1.4.2010	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare "Për heqjen e anijeve të mbytura"	1701
Ligj nr.10 261 datë 1.4.2010	Për disa shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar	1712

LIGJ
Nr.10 255, datë 25.3.2010

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E KONFERENCËS SË HAGËS "PËR MARRJEN E PROVAVE JASHTË SHTETIT NË ÇËSHTJET CIVILE OSE TREGTARE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën e Konferencës së Hagës "Për marrjen e provave jashtë shtetit në çështjet civile ose tregtare", hyrë në fuqi më 7.10.1972, me rezervat dhe deklarimet e parashikuara në këtë ligj.

Neni 2

Në përputhje me paragrafin e parë të nenit 33 të konventës, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën të pranojë për shqyrtim ato letërkërkesa, të cilat hartohen në gjuhën shqipe, ose janë të shoqëruara me përkthimin zyrtar në gjuhën shqipe.

Neni 3

Në përputhje me shkronjën "c" të nenit 35 të konventës, Republika e Shqipërisë deklaron se nuk do të ekzekutojë letërkërkesat e lëshuara, me qëllim marrjen e dokumenteve para shqyrtimit gjyqësor, siç njihet në vendet e së drejtës anglo-saksone (*Common Law*).

Neni 4

Autoritet qendror, në kuptim të nenit 2 të konventës, është Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6499, datë 12.4.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

PËRMBLEDHJE E PRANIMEVE TË ADERIMEVE

(Në marrëdhëniet ndërmjet shteteve kontraktuese, kjo Konventë zëvendëson nenet 8 deri 16 të konventave mbi procedurën civile të vitit 1905 dhe 1954)

KONVENTA PËR MARRJEN E PROVAVE JASHTË SHTETIT NË ÇËSHTJET CIVILE OSE TREGTARE

(Nënshkruar më 18 mars 1970)

Shtetet nënshkruese të kësaj Konvente,

Me dëshirën për të lehtësuar transmetimin dhe ekzekutimin e kërkesave dhe përshtatjen e mëtejshme të metodave të ndryshme që ata përdorin për këtë qëllim,

Me dëshirën për të përmirësuar bashkëpunimin gjyqësor në çështjet civile ose tregtare,

Kanë vendosur të nënshkruajnë një Konventë për këtë qëllim dhe kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme.

KAPITULLI i
LETËRKËRKESAT

Neni 1

Në çështjet civile ose tregtare, një autoritet gjyqësor i një shteti kontraktues, në përputhje me dispozitat e ligjit të atij shteti, mund t'i kërkojë autoritetit kompetent të një shteti tjetër kontraktues, me anë të një letërkërkese, të marrë prova ose të kryejë ndonjë veprim tjetër gjyqësor.

Një letër nuk përdoret për të marrë prova të cilat nuk synohen të përdoren në procedime gjyqësore, të filluara ose të parashikuara.

Shprehja "veprim tjetër gjyqësor" nuk mbulon dorëzimin e dokumenteve gjyqësore ose fillimin e një procesi me anë të të cilit janë ekzekutuar ose zbatuar vendimet ose urdhrat, ose urdhra për masa të përkohshme ose mbrojtëse.

Neni 2

Një shtet kontraktues cakton një autoritet qendror që pranon të marrë letërkërkesa që vijnë nga një autoritet gjyqësor i një shteti tjetër kontraktues dhe t'ia transmetojë ato për ekzekutim autoritetit kompetent. Çdo shtet organizon autoritetin qendror në përputhje me ligjin e vet.

Letrat i dërgohen autoritetit qendror të shtetit të ekzekutimit pa u transmetuar përmes ndonjë autoriteti tjetër të atij shteti.

Neni 3

Një letërkërkesë përcakton:

a) autoritetin që kërkon ekzekutimin e saj dhe autoritetin i cili kërkohet për ta ekzekutuar atë, nëse është i njohur për autoritetin kërkues;

b) emrat dhe adresat e palëve të procedimeve dhe përfaqësuesve të tyre, nëse ka;

c) natyrën e procedimeve për të cilat kërkohen prova, duke dhënë të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me to;

d) provat që duhet të merren ose ndonjë veprim tjetër gjyqësor që duhet të kryhet.

Nëse çmohet e nevojshme, letërkërkesa përcakton, ndër të tjera,

e) emrat dhe adresat e personave që merren në pyetje;

f) pyetjet që duhet t'u drejtohen personave të cilët duhet të merren në pyetje ose një deklaratë mbi subjektin rreth të cilit ata duhet të merren në pyetje;

g) dokumentet ose ndonjë pronë tjetër e patundshme ose personale, që duhet të inspektohen;

h) çdo kërkesë që provat duhet të jepen nën betim ose pohim dhe çdo formë e veçantë që duhet të përdoret;

i) çdo metodë ose procedurë e veçantë e cila duhet të ndiqet sipas nenit 9.

Një letër mund të përmendë gjithashtu çdo informacion të nevojshëm për zbatimin e nenit 11.

Nuk mund të kërkohet asnjë legalizim ose formalitet tjetër.

Neni 4

Një letërkërkesë është në gjuhën e autoritetit, i cili kërkohet për ta ekzekutuar atë ose shoqërohet me një përkthim në atë gjuhë.

Megjithatë, një shtet kontraktues pranon një letër ose në gjuhën angleze, ose frënge, ose një përkthim në një prej këtyre gjuhëve, nëse nuk ka bërë rezervë të autorizuar nga neni 33.

Një shtet kontraktues që ka më shumë se një gjuhë zyrtare dhe për arsye të ligjit të brendshëm, nuk mund të pranojë letra në një prej këtyre gjuhëve për të gjithë territorin e tij, me anë të një deklarate cakton gjuhën në të cilën letra ose përkthimi i saj shprehen për ekzekutim në pjesët e përcaktuara të territorit të tij. Në rast të mospërmbushjes së kësaj deklarate, pa arsye të justifikuar, shpenzimet e përkthimit në gjuhën e kërkuar përballohen nga shteti i origjinës.

Një shtet kontraktues, me anë të një deklarate, mund të përcaktojë gjuhën ose gjuhët e ndryshme nga ato të përmendura në paragrafët pararendës në të cilët një letër mund t'i dërgohet autoritetit të tij qendror.

Çdo përkthim që shoqëron një letër vërtetohet si i saktë ose nga një punonjës diplomatik ose agjent konsullor ose nga një përkthyes i betuar, ose nga çdo person tjetër i autorizuar për këtë në secilin shtet.

Neni 5

Nëse autoriteti qendror çmon se kërkesa nuk përputhet me dispozitat e kësaj Konvente, ai informon menjëherë autoritetin e shtetit të origjinës që transmetoi letërkërkesën e cila përcakton kundërshtimet ndaj letrës.

Neni 6

Nëse autoriteti të cilit i është transmetuar letërkërkesa nuk është kompetent për ta ekzekutuar atë, letra i dërgohet menjëherë autoritetit në po atë shtet, i cili është kompetent për ta ekzekutuar atë në përputhje me dispozitat e ligjit të tij.

Neni 7

Nëse e dëshiron, autoriteti kërkues informohet për kohën dhe vendin ku do të zhvillohen procedimet, me qëllim që palët e interesuara dhe përfaqësuesit e tyre, nëse ka, të mund të jenë të pranishëm. Ky informacion i dërgohet drejtpërdrejt palëve ose përfaqësuesve të tyre, sipas kërkesës së autoritetit të shtetit të origjinës.

Neni 8

Një shtet kontraktues mund të deklarojë se anëtarët e personelit gjyqësor të autoritetit kërkues të një shteti tjetër kontraktues mund të jenë të pranishëm në ekzekutimin e një letërkërkese. Mund të kërkohet autorizim paraprak nga autoriteti kompetent i caktuar nga shteti deklarues.

Neni 9

Autoriteti gjyqësor që ekzekuton një letërkërkesë zbaton ligjin e tij në lidhje me metodat dhe procedurat që duhet të ndiqen.

Megjithatë, ai zbaton një kërkesë të autoritetit kërkues që një metodë ose procedurë e veçantë duhet të ndiqet, nëse pajtohet me ligjin e brendshëm të shtetit të ekzekutimit ose është e pamundur të kryhet për shkak të praktikës dhe procedurës së tij të brendshme ose vështirësive praktike.

Një letërkërkesë ekzekutohet pa vonesë.

Neni 10

Në ekzekutimin e një letërkërkese, autoriteti i kërkuar zbaton masat e nevojshme të detyrimit në rastet dhe në të njëjtën shkallë që parashikohen nga ligji i tij i brendshëm për ekzekutimin e urdhrave të nxjerra nga autoritetet e vendit të tij ose të kërkesave të bëra nga palët në procedimet e brendshme.

Neni 11

Në ekzekutimin e një letërkërkese, personi i interesuar mund të refuzojë të japë prova për sa kohë që ai ka privilegjin ose detyrimin për të refuzuar dhënien e provave:

a) sipas ligjit të shtetit të ekzekutimit; ose

b) sipas ligjit të shtetit të origjinës, dhe privilegji ose detyrimi janë përcaktuar në letër ose në rastin e autoritetit të kërkuar, i është konfirmuar në ndonjë mënyrë tjetër atij autoriteti nga autoriteti kërkues.

Një shtet kontraktues gjithashtu mund të deklarojë se do të respektojë privilegjet dhe detyrimet ekzistuese sipas ligjit të shteteve të ndryshme nga shteti i origjinës dhe shteti i ekzekutimit, në shkallën e përcaktuar në atë deklaratë.

Neni 12

Ekzekutimi i një letërkërkese mund të refuzohet vetëm në shkallën që:

a) në shtetin e ekzekutimit, ekzekutimi i letrës nuk hyn në funksionet e gjyqësorit; ose

b) shteti të cilit i drejtohet çmon se sovraniteti ose siguria e tij do të cenoheshin nga ky veprim.

Ekzekutimi mund të mos refuzohet vetëm për arsye se sipas ligjit të tij të brendshëm, shteti i ekzekutimit kërkon juridiksion ekskluziv mbi subjektin e veprimit ose që ligji i tij i brendshëm nuk do të lejonte një të drejtë veprimi mbi të.

Neni 13

Dokumentet që vendosin ekzekutimin e letërkërkesës dërgohen nga autoriteti i kërkuar për autoritetin kërkues me të njëjtën rrugë që është përdorur nga ky i fundit.

Në çdo rast kur letra nuk është ekzekutuar tërësisht ose pjesërisht, autoriteti kërkues të informohet menjëherë përmes të njëjtës rrugë dhe këshillohet për arsyet përkatëse.

Neni 14

Ekzekutimi i letërkërkesës nuk shkakton riimbursime taksash ose shpenzimesh të çdo natyre.

Megjithatë, shteti i ekzekutimit ka të drejtë t'i kërkojë shtetit të origjinës të riimbursojë tarifat e paguara për ekspertët dhe përkthyesit dhe shpenzimet e shkaktuara nga përdorimi i një procedure të veçantë të kërkuar nga shteti i origjinës sipas nenit 9, paragrafi 2.

Autoriteti i kërkuar, ligji i të cilit detyron vetë palët të sigurojnë prova dhe që nuk është i aftë të ekzekutojë letrën, pasi të ketë marrë miratimin e autoritetit kërkues, mund të caktojë një person të përshtatshëm për ta bërë këtë. Në kërkimin e këtij miratimi, autoriteti i kërkuar shënon shpenzimet e përafërta që do të rezultonin nga kjo procedurë. Nëse autoriteti kërkues jep miratimin e tij, ai riimburson çdo shpenzim të shkaktuar; pa këtë miratim autoriteti kërkues nuk është përgjegjës për shpenzimet.

KAPITULLI ii
MARRJA E PROVAVE NGA PUNONJËSIT DIPLOMATIKË, AGJENTËT KONSULLORË DHE KOMISIONERËT

Neni 15

Në një çështje civile ose tregtare, një punonjës diplomatik ose agjent konsullor i një shteti kontraktues, në territorin e një shteti tjetër kontraktues dhe brenda zonës ku ai ushtron funksionet e tij, mund të marrë prova pa detyrim të shtetasve të një shteti që ai përfaqëson, në mbështetje të procedimeve të filluara në gjykatat e një shteti që ai përfaqëson.

Një shtet kontraktues mund të deklarojë provat që mund të merren nga një punonjës diplomatik ose agjent konsullor, vetëm nëse leja për atë qëllim jepet me kërkesën e bërë prej tij ose saj në emër të autoritetit përkatës të caktuar nga shteti deklarues.

Neni 16

Një punonjës diplomatik ose agjent konsullor i një shteti kontraktues, në territorin e një shteti tjetër kontraktues dhe brenda zonës ku ai ushtron funksionet e tij, mund të marrë prova pa detyrim, të shtetasve të shtetit në të cilin ai ushtron funksionet e tij ose të një shteti të tretë, në mbështetje të procedimeve të filluara në gjykatat e një shteti që ai përfaqëson, nëse:

a) një autoritet kompetent i caktuar nga shteti në të cilin ai ushtron funksionet e tij, ka dhënë leje qoftë në përgjithësi ose në rastin e veçantë, dhe

b) ai respekton kushtet që autoriteti kompetent ka përcaktuar në leje.

Një shtet kontraktues mund të deklarojë se provat mund të merren sipas këtij neni, pa lejen e tij paraprake.

Neni 17

Në një çështje civile ose tregtare, një person i caktuar si komisioner për atë qëllim, pa detyrim, mund të marrë prova në territorin e një shteti kontraktues, në mbështetje të procedimeve të filluara në gjykatat e një shteti tjetër kontraktues, nëse:

a) një autoritet kompetent i caktuar nga shteti ku duhet të merren provat, ka dhënë lejen e tij ose në përgjithësi, ose në rastin e veçantë; dhe

b) ai respekton kushtet që autoriteti kompetent ka përcaktuar në leje.

Një shtet kontraktues mund të deklarojë se provat mund të merren sipas këtij neni pa lejen e tij paraprake.

Neni 18

Një shtet kontraktues mund të deklarojë se një punonjës diplomatik, agjent konsullor ose komisioner i autorizuar për të marrë prova sipas neneve 15, 16 ose 17, mund të aplikojë pranë autoritetit kompetent të caktuar nga shteti deklarues për asistencën e nevojshme për marrjen e provave me detyrim. Deklarata mund të përmbajë kushte të tilla që shteti deklarues mund t'i çmojë të përshtatshme për t'i vendosur.

Nëse autoriteti plotëson aplikimin, ai zbaton të gjitha masat e detyrimit që janë të nevojshme dhe të parashikuara nga ligji i tij për përdorim në procedimet e brendshme.

Neni 19

Në dhënien e lejes së përmendur në nenet 15, 16 ose 17 ose në plotësimin e aplikimit të përmendur në nenin 18, autoriteti kompetent mund të parashtrojë kushtet që çmon të nevojshme, ndër të tjera, në lidhje me kohën dhe vendin e marrjes së provave. Në mënyrë të ngjashme, ai mund të kërkojë që t'i jepet njoftim i arsyeshëm paraprak në lidhje me kohën, datën dhe vendin e marrjes së provave; në këtë rast një përfaqësues i autoritetit ka të drejtën të jetë i pranishëm në marrjen e provave.

Neni 20

Në marrjen e provave, sipas neneve të këtij kapitulli, personat e interesuar mund të përfaqësohen ligjërisht.

Neni 21

Kur një punonjës diplomatik, agjent konsullor ose komisioner autorizohet sipas neneve 15, 16 ose 17 të marrë prova:

a) ai mund të marrë të gjitha llojet e provave të cilat nuk janë në mospërputhje me ligjin e shtetit ku është marrë prova apo në kundërshtim me autorizimin e dhënë në zbatim të neneve më lart, dhe ka autoritet brenda këtyre limiteve për të administruar një betim apo për të marrë një pohim;

b) një kërkesë ndaj personit për t'u paraqitur apo për të dhënë prova, përveç kur marrësi është një shtetas i shtetit ku veprimi ka mbetur pezull, hartohet në gjuhën e vendit ku është marrë prova apo shoqërohet nga një përkthim në këtë gjuhë;

c) kërkesa njofton personin se ai mund të përfaqësohet ligjërisht dhe, në çdo shtet që nuk ka regjistruar një deklaratë sipas nenit 18, njofton gjithashtu se ai nuk është i detyruar të paraqitet apo të japë prova;

d) prova mund të merret në mënyrën e parashikuar nga ligji i zbatueshëm në gjykatë, ku veprimi është lënë pezull, me kusht që kjo mënyrë të mos ndalohet nga ligji i shtetit ku merret prova;

e) një person që i kërkohet të japë prova mund të kërkojë privilegje dhe detyra për të refuzuar dhënien e provave që përfshihen në nenin 11.

Neni 22

Fakti që një përpjekje për të marrë prova, sipas procedurave të parashtruara në këtë kapitull ka dështuar për shkak të refuzimit të një personi për të dhënë prova, nuk pengon një kërkesë të bërë më pas për të marrë prova në përputhje me kapitullin I.

KAPITULLI iii
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 23

Një shtet kontraktues, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit apo aderimit, mund të deklarojë që ai nuk do t'i ekzekutojë letërkërkesat e lëshuara me qëllim marrjen e dokumenteve para shqyrtimit gjyqësor siç njihet në vendet e së drejtës anglo-saksone (Common Law).

Neni 24

Një shtet kontraktues mund të përcaktojë autoritete të tjera krahas autoritetit qendror dhe të përcaktojë masën e kompetencës. Sidoqoftë, letërkërkesat në të gjitha rastet mund t'i dërgohen autoritetit qendror.

Shtetet federale janë të lira të përcaktojnë më shumë se një autoritet qendror.

Neni 25

Një shtet kontraktues i cili ka më shumë se një sistem ligjor mund të përcaktojë autoritetet e një prej këtyre sistemeve, të cilat kanë kompetencë të posaçme për të ekzekutuar letërkërkesat në zbatim të kësaj Konvente.

Neni 26

Një shtet kontraktues, nëse kërkohet të veprojë kështu, për shkak të kufizimeve kushtetuese, mund të kërkojë riimbursim nga shteti i origjinës për tarifat dhe shpenzimet në lidhje me zbatimin e letërkërkesës në shërbim të procesit të nevojshëm për të detyruar një person të paraqitet për të dhënë prova, shpenzimet e pjesëmarrjes së këtij personi dhe shpenzimet e çdo përkthimi të provës.

Aty ku shteti ka bërë një kërkesë sipas paragrafit më lart, çdo shtet tjetër kontraktues mund të kërkojë nga ai shtet riimbursimin e tarifave dhe shpenzimeve të njëjta.

Neni 27

Dispozitat e kësaj Konvente nuk pengojnë një shtet kontraktues nga:

a) deklarimi se letërkërkesat mund t'u përcillen autoriteteve të tij gjyqësore nëpërmjet kanaleve të tjera nga ato të parashikuara në nenin 2;

b) lejimi, sipas ligjit apo praktikës së brendshme, të çdo akti të parashikuar në këtë Konventë për t'u kryer në kushte më pak kufizuese;

c) lejimi, sipas ligjit dhe praktikës së brendshme, të metodave të marrjes së provës të tjetra nga ato të parashikuara në këtë Konventë.

Neni 28

Kjo Konventë nuk pengon një marrëveshje ndërmjet çdo dy apo më shumë shteteve kontraktuese për t'u shmangur nga:

a) dispozitat e nenit 2 në lidhje me metodat e përcjelljes së letërkërkesave;

b) dispozitat e nenit 4 në lidhje me gjuhët të cilat mund të përdoren;

c) dispozitat e nenit 8 në lidhje me prezencën e stafit gjyqësor në ekzekutimin e letrave;

d) dispozitat e nenit 11 në lidhje me privilegjet dhe detyrimet e dëshmitarëve për të refuzuar dhënien e provave;

e) dispozitat e nenit 13 në lidhje me metodat e kthimit të letrave të ekzekutuara autoritetit kërkues;

f) dispozitat e nenit 14 në lidhje me tarifat dhe shpenzimet;

g) dispozitat e kapitullit II.

Neni 29

Ndërmjet palëve në këtë Konventë, të cilët janë gjithashtu palë në një apo të dyja Konventat për Procedurën Civile, të nënshkruar në Hagë më 17 korrik 1905 dhe 1 mars 1954, kjo Konventë zëvendëson nenet 8-16 të konventave së mëparshme.

Neni 30

Kjo Konventë nuk ndikon në zbatimin e nenit 23 të konventës së 1905 apo të nenit 24 të konventës së 1954.

Neni 31

Marrëveshjet shtesë ndërmjet palëve në konventat e 1905 dhe 1954 konsiderohen njëlloj të zbatueshme për këtë Konventë, përveç kur palët bien dakord ndryshe.

Neni 32

Pa cenuar dispozitat e neneve 29 dhe 31, kjo Konventë nuk u shmanget konventave që përfshijnë dispozitat mbi çështje që mbulohen nga kjo Konventë, në të cilën shtetet kontraktuese janë ose bëhen palë.

Neni 33

Një shtet, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit apo aderimit, mund të përjashtojë pjesërisht apo tërësisht zbatimin e dispozitave të paragrafit 2 të nenit 4 dhe të kapitullit II. Asnjë rezervë tjetër nuk do lejohet.

Çdo shtet kontraktues në çdo kohë mund të tërheqë rezervën e bërë prej tij; rezerva pushon së qeni në fuqi në ditën e gjashtëdhjetë pas njoftimit të tërheqjes.

Kur një shtet ka bërë një rezervë, çdo shtet tjetër i prekur prej saj mund të zbatojë të njëjtën rregull ndaj shtetit që bën rezervën.

Neni 34

Një shtet mund ta tërheqë apo ta modifikojë në çdo kohë një deklaratë.

Neni 35

Një shtet kontraktues, në çdo kohë të depozitimit të instrumentit të ratifikimit apo aderimit, ose në një datë të mëvonshme, informon Ministrinë e Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta mbi përcaktimin e autoriteteve në zbatim të nenit 2, 8, 24 dhe 25.

Një shtet kontraktues në të njëjtën mënyrë informon ministrinë, kur është e nevojshme, për sa më poshtë:

a) përcaktimi i autoriteteve, që duhet të njoftohen, leja e të cilave mund të kërkohet, dhe ndihma e të cilave mund të kërkohet në marrjen e provave nga punonjësit diplomatikë dhe agjentët konsullorë në zbatim të neneve, përkatësisht 15, 16, dhe 18;

b) përcaktimi i autoriteteve, autorizimi i të cilave mund të kërkohet në marrjen e provave nga komisionerët në zbatim të nenit 17 dhe të atyre të cilat mund të japin ndihmë parashikuar në nenin 18;

c) deklaratat në zbatim të neneve 4,8,11,15,16,17,18, 23 dhe 27;

d) çdo tërheqje ose modifikim i përcaktimeve dhe deklaratave më lart;

e) tërheqja e çdo rezerve.

Neni 36

Çdo vështirësi që mund të dalë ndërmjet shteteve kontraktuese, në lidhje me funksionimin e kësaj Konvente, vendoset nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 37

Kjo Konventë hapet për nënshkrim nga shtetet e përfaqësuara në sesionin e njëmbëdhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.

Ajo ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit depozitohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Neni 38

Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit referuar në paragrafin e dytë të nenit 37.

Konventa hyn në fuqi për çdo shtet nënshkrues, i cili e ratifikon më pas në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit.

Neni 39

Çdo shtet i papërfaqësuar në sesionin e njëmbëdhjetë të Konferencës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, i cili është anëtar i kësaj Konference ose i Kombeve të Bashkuara ose të një agjencie të specializuar të kësaj organizate ose një pale në Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mund të aderojë në këtë Konventë, mbasi të ketë hyrë në fuqi në përputhje me paragrafin e parë të nenit 38.

Instrumenti i aderimit depozitohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Konventa hyn në fuqi për një shtet që aderon në të në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të tij të aderimit.

Aderimi ka efekt vetëm përsa u përket marrëdhënieve ndërmjet shteteve aderuese dhe atyre shteteve kontraktuese, pasi të kenë deklaruar pranimet e tyre të aderimit. Kjo deklaratë depozitohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta; kjo ministri ua përcjell një kopje të certifikuar, nëpërmjet kanaleve diplomatike, secilit prej shteteve kontraktuese.

Konventa hyn në fuqi ndërmjet shtetit aderues dhe shtetit që ka deklaruar pranimin e aderimit të saj në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të deklaratës së pranimit.

Neni 40

Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit apo aderimit, mund të deklarojë se kjo Konventë do të shtrihet në të gjitha territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare për të cilat ajo është përgjegjëse, ose

në një ose më shumë prej tyre. Kjo deklaratë ka efekt në datën e hyrjes në fuqi të Konventës për shtetin e interesuar.

Në çdo kohë pas kësaj, kjo shtrirje i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta.

Konventa hyn në fuqi për territoret e përmendura në këtë shtrirje në ditën e gjashtëdhjetë pas njoftimit të treguar në paragrafin paraprirës.

Neni 41

Kjo Konventë mbetet në fuqi për pesë vjet nga data e hyrjes së tij në fuqi në përputhje me paragrafin e parë të nenit 38, edhe për shtetet të cilat e kanë ratifikuar atë apo aderuar në të më pas.

Nëse nuk ka asnjë denoncim, ajo rinovohet në mënyrë të heshtur çdo pesë vjet.

Çdo denoncim i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vendeve të Ulëta të paktën gjashtë muaj para mbarimit të periudhës pesëvjeçare.

Ajo mund të kufizohet në disa territore ku zbatohet Konventa.

Denoncimi ka efekt vetëm, përsa i përket shtetit, i cili ka bërë njoftimin e tij. Konventa mbetet në fuqi për shtetet e tjera kontraktuese.

Neni 42

Ministria e Punëve të Jashtme e Vendeve të Ulëta njofton shtetet e referuara në nenin 37 dhe shtetet të cilat kanë aderuar në përputhje me nenin 39 për sa më poshtë:

a) nënshkrimin dhe ratifikimin referuar në nenin 37;

b) datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në përputhje me paragrafin e parë të nenit 38;

c) aderimet referuar në nenin 39 dhe datat në të cilat ato hyjnë në fuqi;

d) shtrirjet referuar në nenin 40 dhe datat në të cilat ato hyjnë në fuqi;

e) përcaktimet, rezervat dhe deklaratat referuar në nenet 33 dhe 35;

f) denoncimet referuar në paragrafin e tretë të nenit 41.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, të autorizuar sipas rregullit, e kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Hagë, në ditën e 18 marsit 1970, në anglisht dhe frëngjisht, ku të dyja tekstet janë njëlloj autentike, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Qeverisë së Vendeve të Ulëta, dhe një kopje e certifikuar e saj i dërgohet, nëpërmjet kanaleve diplomatike, secilit prej shteteve të përfaqësuara në sesionin e njëmbëdhjetë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private.

LIGJ
Nr.10 256, datë 25.3.2010

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË GREQISË PËR KËRKIMIN, ZHVARRIMIN, IDENTIFIKIMIN DHE VARRIMIN E USHTARAKËVE GREKË, TË RËNË NË SHQIPËRI GJATË LUFTËS GREKO-ITALIANE TË VITEVE 1940-1941 DHE PËR NDËRTIMIN E VENDPREHJES PËR TA BRENDA TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 e 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940-1941 dhe për ndërtimin e vendprehjes për ta brenda territorit të Republikës së Shqipërisë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6500, datë 12.4.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
MBI BASHKËPUNIMIN NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS GREKE MBI KËRKIMIN, ZHVARRIMIN, IDENTIFIKIMIN DHE VARRIMIN E USHTARAKËVE GREKË TË RËNË NË LUFTË NË SHQIPËRI GJATË LUFTËS GREKO- ITALIANE TË VITIT 1940 -1941 DHE NDËRTIMIN E VENDPREHJES PËR TA NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Greke, më poshtë të quajtura "Palët";

duke mbajtur parasysh Traktatin e Miqësisë, Bashkëpunimit, Sigurisë dhe Marrëdhënieve të Fqinjësisë së Mirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Greke, nënshkruar në Tiranë, më 21 mars 1996;

duke njohur dimensionin humanitar dhe rëndësinë morale të varrimit të përshtatshëm dhe me nderime të ushtarakëve grekë, të rënë në luftë në tokën shqiptare, në luftën greko – italiane, gjatë Luftës së II Botërore të viteve 1940-1941;

janë marrë vesh si më poshtë:

Neni 1

1. Në nderim të ushtarakëve dhe shtetasve të tjerë grekë që kanë shoqëruar ushtrinë me status të veçantë (anëtarë të Kryqit të Kuq, personel mjekësor dhe priftërinj), të rënë në luftë gjatë luftës greko – italiane të viteve 1940-1941, të ndërtohet vendprehje në Shqipëri, me shpenzimet e Qeverisë së Republikës Greke. Personat e përmendur më sipër, më poshtë, do të quhen "persona të rënë në luftë".

2. Vendprehja e sipërpërmendur do të ndërtohet:

a) në një shesh, 4 km përpara qytetit të Këlcyrës, në rrugën kryesore Lekli – Këlcyrë që Qeveria Shqiptare do ta vërë në dispozicion për këtë qëllim, me sipërfaqe 10 000 m² (shih shtojcën me hartën dhe koordinatat e vendndodhjes);

b) në një shesh, në hyrje të fshatit Bularat, me sipërfaqe 1610 m² (shih shtojcën me hartën dhe koordinatat e vendndodhjes).

3. Në rast se, për shkaqe të detyrueshme publike, sheshi i caktuar për vendprehje do të nevojitet për një qëllim tjetër, atëherë Qeveria Shqiptare do të vërë në dispozicion të Qeverisë Greke një shesh tjetër të përshtatshëm, në afërsi të infrastrukturës së ndërtimit të varrezës, do të mbulojë shpenzimet për rivarrimin e eshtrave dhe sistemimin e varreve të reja. Përzgjedhja e sheshit të ri, përshtatja e tij, lëvizja dhe rivarrimi i eshtrave do të bëhet me pëlqimin e të dyja palëve.

4. Të gjitha eshtrat e personave të rënë në luftë, gjatë luftës greko – italiane të viteve 1940-1941, që ekzistojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të vendosen në këto vendprehje.

5. Kërkimi, zhvarrimi, identifikimi dhe varrimi i eshtrave do të bëhet nga një komitet i përbashkët me ekspertë shqiptarë dhe grekë. Ne mbledhjen e tij të parë, ky komitet do të hartojë rregullat procedurale të veprimtarisë së tij.

6. Kërkimi, zhvarrimi, identifikimi dhe varrimi do të bëhen mbi bazën e arkivave ekzistuese dhe dëshmive të asaj kohe, mbështetur mbi hartat e miratuara nga komiteti i përbashkët.

7. Pala greke do të mbulojë shpenzimet për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin. Veç kësaj, pala greke do të sigurojë pajisjet e nevojshme teknike dhe infrastrukturën logjistike.

8. Ceremonitë zyrtare në përkujtim të personave të renë në luftë do të organizohen nga përfaqësuesit e Republikës Greke dhe të Republikës së Shqipërisë, çdo vit, më 28 tetor. Në këto ceremoni mund të marrin pjesë edhe përfaqësues të shoqatave të të afërmve dhe miqve të të rënëve.

Neni 2

Memoriali kushtuar "Personave të rënë në luftë" do të përbëhet nga një pllakë mermeri, me mbishkrimin e mëposhtëm, të gdhendur në gjuhët shqip dhe greqisht:

"NË KUJTIM TË USHTARAKËVE GREKË TË RËNË NË LUFTË GJATË LUFTËS GREKO – ITALIANE TË VITEVE 1940-1941".

Neni 3

Në bazë të kësaj Marrëveshjeje, pala greke merr përsipër si më poshtë:

a) Të vërë në dispozicion një ekip ekspertësh, të cilët do të marrin pjesë në komitetin e përbashkët të ekspertëve për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e eshtrave, staf mbështetës, si dhe personel tjetër, materialet dhe mjetet e nevojshme për kërkimin, nxjerrjen dhe mbledhjen e eshtrave të personave të renë në luftë;

b) Për të lehtësuar në përgjithësi kërkimet, të sigurojë çdo lloj materiali arkivor, lidhur me vendndodhjen e varreve individuale ose kolektive të personave të rënë në luftë dhe çdo të dhënë të disponueshme (skica topografike, harta ose çdo burim tjetër që mund të shërbejë si dëshmi);

c) Të sigurojë personelin e nevojshëm, i cili do të hyjë në Shqipëri për të bërë transportin e materialeve dhe mjeteve të nevojshme për ndërtimin e varrezave;

d) Të sigurojë realizimin e të gjitha kërkesave higjienike dhe shëndetësore, lidhur me proceset e zhvarrimit, identifikimit dhe varrimit, në përputhje me legjislacionin përkatës shqiptar;

e) Të mbulojë të gjitha shpenzimet e mëposhtme:

1. shpenzimet për transportin e personelit, mjeteve dhe materialeve nga Greqia në Shqipëri, për mbledhjen e eshtrave dhe ndërtimin e varrezave;

2. furnizimin me ujë, energji elektrike, lidhjen telefonike me varrezat; si dhe

3. ndërtimin e një pike parkimi aty pranë dhe lidhjen ndërmjet tyre me rrugët më të afërme;

f) Të sigurojë, pas përfundimit të ndërtimit, mirëmbajtjen e vendprehjes të sipërpërmendur, duke dhënë fondet e nevojshme për shpenzimet operative dhe të pajisë personelin e punësuar me ekspertizën e nevojshme të mirëmbajtjes.

Neni 4

Në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, pala shqiptare merr përsipër si më poshtë:

a) Të vërë në dispozicion një ekip ekspertësh, të cilët do të jenë pjesë e komitetit të përbashkët të ekspertëve për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e eshtrave dhe të ndërmarrë hapat e nevojshme për të ndihmuar dhe lehtësuar detyrat e komitetit në fjalë;

b) Për lehtësimin në përgjithësi të kërkimit, të sigurojë çdo lloj materiali arkivor, lidhur me vendndodhjen e varreve individuale ose kolektive të personave të rënë në luftë dhe çdo lloj të dhënash të disponueshme (skica topografike, harta ose çdo burim tjetër që mund të shërbejë si dëshmi);

c) Të marrë të gjitha masat për të siguruar, për aq kohë sa të jetë e nevojshme, hyrjen, lëvizjen dhe qëndrimin e personelit grek në Shqipëri, si dhe transportin e materialeve dhe mjeteve në sheshet e miratuara më parë;

d) Pajisjet dhe mjetet e transportit, të importuara përkohësisht, gjatë momentit të hyrjes së tyre në territorin shqiptar nuk do t'i nënshtrohen zhdoganimit, me kusht që kur të mbarojnë punimet, ato të kthehen në vendin e tyre të origjinës;

e) Materialet dhe pajisjet e destinuara për procesin e identifikimit dhe ndërtimin e varrezave nuk do t'u nënshtrohen detyrimeve doganore apo taksave të tjera, me kusht që, krahas deklaratave të rregullta doganore, autoriteteve shqiptare do t'u dorëzohet një listë e saktë e mallrave të importuara dhe një deklaratë nga personi i autorizuar nga Qeveria Greke, i cili do të konfirmojë zyrtarisht se mallrat e deklaruara do të përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje;

f) Të ndihmojë pa shpërblim në realizimin e punimeve të përmendura në nenin 3, paragrafi e (2) të kësaj Marrëveshjeje;

g) Të marrë të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin pa pengesa të shërbimeve përkujtimore të përmendura në nenin 1, paragrafi 8 të kësaj Marrëveshjeje, në gjuhët shqip dhe greqisht;

h) Të njohë palën greke me kërkesat e legjislacionit shqiptar, lidhur me procedurat e zhvarrimit dhe procesin e rivarrimit të përmendur në nenin 3, paragrafi d të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

1. Lidhur me procesin e kërkimit, zhvarrimit, identifikimit dhe rivarrimit të të rënëve në luftë, komiteti i përbashkët shqiptaro-grek i ekspertëve, do të mbajë evidenca me të dhëna të sakta, duke regjistruar varret ekzistuese, ato të reja, si dhe të dhënat vetjake e shenjat e identifikimit që nga lindja.

2. Për zhvendosjen e eshtrave të personave të rënë në luftë nga Republika e Shqipërisë në Republikën Greke, pala greke duhet të bëjë kërkesë me shkrim. Autoritetet shqiptare do të japin leje për zhvendosjen në fjalë, vetëm pasi të jetë paraqitur kërkesa zyrtare përkatëse.

3. Për të gjitha kërkesat që i drejtohen palës shqiptare, lidhur me çdo transferim të mundshëm të eshtrave të personave të rënë në luftë në një vend të tretë, nevojitet konfirmimi zyrtar nga pala greke.

4. Pala shqiptare nuk do të mbulojë asnjë shpenzim financiar për zhvarrimin, identifikimin dhe transferimin në vende të tjera të eshtrave të të rënëve.

5. Në rast se në varret ekzistuese të luftës greko-italiane, do të gjenden eshtra të personave të tjerë që nuk janë të rënë në detyrë, atëherë kjo çështje do të trajtohet në pajtim me vendimin e marrë mbi mbajtjen dhe ruajtjen e tyre, në bazë të vendimit të komitetit të përbashkët të ekspertëve. Shpenzimet e rivarrimit të tyre do të mbulohen nga pala greke.

Neni 6

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet në pajtim me legjislacionin shqiptar.

2. Secila palë ka të drejtë të propozojë ndryshime për çdo dispozitë të kësaj Marrëveshjeje. Çdo ndryshim i tillë do të hyjë në fuqi, pasi të jetë dhënë edhe pëlqimi me shkrim i palës tjetër, në pajtim me dispozitat e nenit 7.

3. Çdo mospajtim ndërmjet palëve, lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet me bisedime të drejtpërdrejta nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 7

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas shkëmbimit të notave me shkrim ndërmjet palëve, duke informuar njëra-tjetrën mbi përfundimin e procedurave të tyre të brendshme.

2. Bërë në Tiranë, më 9 shkurt, në dy kopje, në gjuhën shqipe, greke dhe angleze, duke pasur të gjitha tekstet fuqi të barabarta, në rast të ndryshimeve në interpretim, do të mbizotërojë teksti në anglisht.

Duke dëshmuar sa më sipër, nënshkruesit e pajisur me plotfuqishmërinë e duhur, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë Zana Xhuka Zëvendësministre e Mbrojtjes	Për Qeverinë e Republikës Greke Constanttine Tassaulas Zëvendësministër i Mbrojtjes

PLANVENDOSJE
E VARREVE TË USHTARËVE GREKË GRYKA E KËLCYRËS PËRMET

Koordinatat x,y janë në bazë të projeksionit UTM (WGS 84)



SHK 1:2500

SIPËRFAQJA E PËRGJ = 1610 m^2



LIGJ
Nr.10 257, datë 25.3.2010

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8752, DATË 26.3.2001 "PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE PËR ADMINISTRIMIN DHE MBROJTJEN E TOKËS"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në këtë ligj dhe në aktet e tjera ligjore e nënligjore, emërtimi "Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës" zëvendësohet me emërtimin "Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT)".

Neni 2

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 1

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë:

a) rregullat themelore të administrimit të tokës bujqësore, në pronësi private dhe shtetërore dhe të disa prej kategorive të tjera të resurseve;

b) strukturat shtetërore pranë qeverisjes vendore, të ngarkuara për administrimin e tokës, si dhe funksionet e detyrat e tyre.".

Neni 3

Në nenin 2 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. "Tokë bujqësore" ka kuptimin sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 2 të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore".

2. Në pikën 5 fjalët "në ligjin nr. 7623, datë 13.10.1995 "Për pyjet dhe Policinë Pyjore" zëvendësohen me fjalët "në ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar.".

3. Në pikën 6 fjalët "në ligjin nr. 7917, datë 13.4.1995 "Për kullotat dhe livadhet" zëvendësohen me fjalët "në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor".

4. Pika 12 ndryshohet si më poshtë:

"12. "Mbrojtje toke" ka të njëjtin kuptim me përcaktimin e bërë në ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore".

5. Pas pikës 12 shtohen pikat 13 e 14 me këtë përmbajtje:

"13. "Funksion i deleguar, i detyrueshëm" ka kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.

14. "Kategori të resurseve" janë sipërfaqet e tokave bujqësore, të fondit pyjor, të fondit kullosor, sipas përcaktimeve të pikave 4, 5 e 6 të këtij neni, si dhe sipërfaqet e brigjeve të lumenjve, të tokave të pafrytshme dhe të tokave urbane (trojeve).".

Neni 4

Titulli i kreut II "Organizimi" zëvendësohet me titullin "Organizimi i strukturave të administrimit dhe të mbrojtjes së tokës".

Neni 5

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 3

Për administrimin dhe mbrojtjen e tokës, pranë këshillit të qarkut krijohet drejtoria e administrimit dhe mbrojtjes së tokës (DAMT), në përbërje të së cilës janë:

a) sektori i administrimit të tokës, si funksion i deleguar, i detyrueshëm, i Këshillit të Ministrave;

b) inspektorati i mbrojtjes së tokës (IMT) në nivel sektori, si funksion i këshillit të qarkut, që realizohet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore"".

Neni 6

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin e parë, emërtimi “Përgjegjësi i seksionit” zëvendësohet me emërtimin “Drejtor i DAMT-së, përgjegjësit e sektorëve”.

2. Pas paragrafit të parë shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Në procedurën e emërimit të drejtorit të DAMT-së në qark, në komitetin *ad hoc*, të krijuar në institucionin e këshillit të qarkut, dy specialistë të njohur nga fusha përkatëse caktohen nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, sipas ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

Kryetari i Këshillit të qarkut emëron drejtorin e DAMT-së pas miratimit paraprak të drejtuesit të strukturës, që mbulon administrimin e tokave në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Drejtuesi i strukturës, që mbulon administrimin e tokave në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, ka të drejtë të kërkojë zëvendësimin e drejtorit të DAMT-së, nëse ky i fundit nuk kryen detyrën. Në këtë rast, kryetari i këshillit të qarkut fillon procedurat ligjore për shkarkimin e tij, sipas ligjit nr.8549 datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil””.

Neni 7

Në nenin 6, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komunë dhe/ose bashki ka varësi teknike nga DAMT-ja e qarkut.”.

Neni 8

Në nenin 8, në fund të paragrafit të parë shtohen fjalët “si dhe strukturës që mbulon administrimin e tokave në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.

Neni 9

Titulli i kreut III “Objekti dhe funksionet” zëvendësohet me titullin “Administrimi i tokës dhe funksionet e detyrat e strukturave shtetërore pranë qeverisjes vendore”.

Neni 10

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

Zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës kryen këto funksione dhe detyra:

a) përgatit dhe ia paraqet për miratim strukturave përgjegjëse të komunës dhe/ose bashkisë kërkesat dhe dokumentacionin e personave fizikë apo juridikë për qiradhënien, për dhënien e lejeve të shfrytëzimit ose për format e tjera të transferimit të të drejtave, të parashikuara me akte ligjore e nënligjore, të tokave bujqësore të pandara dhe të brigjeve të lumenjve, që me ligj i kalojnë në pronësi ose administrim qarkut, komunës dhe/ose bashkisë;

b) grumbullon informacionin gjeografik dhe ruan hartat e dokumentacionin që ka në varësi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Mënyrat e ushtrimit të funksioneve të parashikuara në këtë nen përcaktohen me akte nënligjore të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 11

Neni 10 shfuqizohet.

Neni 12

Pas nenit 11 shtohet neni 11/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 11/1

1. Në tokat bujqësore të kategorisë së parë, të dytë, të tretë dhe të katërt të bonitetit, miratimi i kalimit të sipërfaqeve për ndërtime bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm për rastet e domosdoshme, si më poshtë:

a) rrugët kombëtare dhe rurale, që lidhin qendrat e banuara me njëra-tjetrën;

b) hekurudhat, aeroportet dhe portet detare;

c) për shpim, kërkim dhe shfrytëzim të burimeve të naftës dhe gazit;

ç) hidrocentralet;

d) për varreza publike;

dh) në funksion të mbrojtjes kombëtare;

e) shtesat e sipërfaqeve në territore, pranë objekteve ekzistuese, me karakter ekonomik dhe prodhues, të ndërtuara në mënyrë të ligjshme, por jo më shumë se sipërfaqja ekzistuese, për zgjerim të së njëjtës veprimtari.

Shtesa e sipërfaqes nuk mund të jetë më e madhe se 3 ha dhe kërkesa për shtesë bëhet vetëm një herë.

2. Studimet dhe propozimet për ndërtime, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshirë edhe zgjerimin e vijave kufizuese të qendrave të banuara, përgatiten dhe paraqiten për miratim nga institucioni shtetëror, që mbulon veprimtaritë ndërtimore dhe, në çdo rast, kanë për bazë zbatimin e detyrimeve, që rrjedhin nga pika 2 e nenit 14 të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”.

3. Ndryshimi i tokave bujqësore të kategorive nga V deri në X të bonitetit në kategori të resurseve të tjera, si tokë urbane (truall), si dhe për veprimtari minerare e gjeologjike, për gurore e kariera, bëhet si më poshtë:

a) për sipërfaqe deri në 30 ha, me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) për sipërfaqe mbi 30 ha, me ligj të veçantë.

4. Kalimi i tokave bujqësore në kategori të resurseve të tjera, si pyll, tokë pyjore, kullotë dhe livadh, si dhe anasjelltas, bëhet si më poshtë:

a) për sipërfaqe deri në 1 ha, me miratimin e përbashkët të ministrave përkatës, që i administrojnë këto resurse;

b) për sipërfaqe mbi 1 ha, me miratimin e Këshillit të Ministrave.

5. Kalimi i tokës bujqësore në kategori të tokës së pafrytshme dhe anasjelltas bëhet si më poshtë:

a) për sipërfaqe deri në 30 ha, me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) për sipërfaqe mbi 30 ha, me ligj të veçantë.

6. Rregullat dhe procedurat për ndryshimet e kategorive të resurseve, sipas pikave 1 deri në 5 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 13

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12

1. DAMT-ja mban dhe ruan arkivin me dokumentacionin themelor kadastral, si librat e tokës, librat e ngastrave, planimetritë, hartat kadastrale, topografike dhe dokumente të tjera ekzistuese të arkivit të kadastrës. Në rastet e dëmtimeve fizike të tyre, të shkaktuara nga kohëzgjatja e përdorimit dhe faktorë të tjerë, kjo drejtori merr masa për përtëritjen e tyre, duke siguruar ruajtjen e origjinalit bashkë me kopjen e përtërirë, në mënyrë të përhershme, në arkiv.

2. Kjo drejtori krijon dokumentacionin e ri për administrimin e tokës, nëpërmjet shfrytëzimit të dokumentacionit ekzistues, të dokumentacionit që disponohet nga institucione të tjera shtetërore dhe që përmban informacion për tokën dhe kategoritë e tjera të resurseve, të produkteve që krijohen nga zbatimi i programeve dhe i projekteve, që kanë si objekt tokën bujqësore, nëpërmjet GIS-së, të matjeve të thjeshta, inventarizimeve, rilevimeve topografike, fotografimeve ajrore, pamjeve satelitore etj.

Lloji i dokumentacionit kadastral që mbahet e përdoret, në bazë të të cilit kryhen veprimet administrative e ligjore për resurset në juridiksion të qarkut, është unik dhe përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. DAMT-ja përditëson dhe pasqyron në dokumentacionin kadastral:

a) ndryshimet e ndodhura në kategoritë e resurseve, që vijnë si pasojë e ligjeve, vendimeve të Këshillit të Ministrave, si dhe strukturave të tjera shtetërore, që kanë tagrin ligjor e kompetencën e ndryshimeve të kategorisë së resurseve;

b) ndryshimet në kategorinë e tokës bujqësore, bashkë me aktin përkatës të strukturës shtetërore, që ka miratuar ndryshimin.

4. DAMT-ja kryen shërbime dhe jep informacione në bazë të dokumentacionit që disponon, sipas pikës 1 të këtij neni, për institucione shtetërore, si dhe për persona fizikë dhe juridikë për:

a) madhësinë dhe vendndodhjen e ngastrave bazë kadastrale të tokës bujqësore;

b) statusin juridik mbi pronësinë e tokës për të gjitha zonat kadastrale rurale, ku nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar dhe rezultatet e këtij regjistrimi nuk janë marrë në dorëzim nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP).

Për zonat kadastrale rurale, ku është kryer regjistrimi fillestar dhe rezultatet e këtij regjistrimi janë marrë në dorëzim nga ZVRPP-ja, vërtetimet që kërkohen për statusin juridik të pronësisë mbi tokën bujqësore, në cilësinë e pasurisë së paluajtshme, lëshohen nga ky institucion;

c) kategorinë e tokës bujqësore, sipas studimit të bonitetit;

ç) sipërfaqet në pronësi private të personave fizikë ose juridikë të periudhës para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 108, datë 29.8.1945 "Për reformën agrare", në çdo rast kur për këtë ekzistojnë të dhëna në dokumentacionin që mbahet në arkivin e DAMT-së.

5. Kryerja e shërbimeve dhe dhënia e informacioneve për institucione shtetërore bëhen falas, ndërsa për personat fizikë dhe juridikë bëhen me pagesë, sipas tarifave të miratuara nga ministri.

Nga fondi financiar vjetor, që krijohet nga këto shërbime, 40 për qind e tij jepet për t'u përdorur për mbulimin e veprimtarive të DAMT-së.".

Neni 14

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 13

1. DAMT-ja përgatit evidencën e gjendjes dhe të ndryshimeve të kategorive për të gjithë territorin në juridiksion të qarkut, brenda muajit janar të vitit pasardhës.

2. Kryetari i komunës dhe/ose bashkisë ka për detyrë që, nëpërmjet ZMMT-së, t'i dërgojë DAMT-së evidencën e gjendjes dhe të ndryshimit vjetor të kategorive të resurseve brenda datës 15 janar të vitit pasardhës. Në përgatitjen e të dhënave angazhon edhe zyrën e urbanistikës të komunës dhe/ose bashkisë.

3. Drejtoria rajonale e shërbimit pyjor të qarkut ka për detyrë t'i dërgojë DAMT-së, brenda muajit janar të vitit pasardhës, evidencën e gjendjes dhe të ndryshimeve vjetore të kategorisë së resurseve, në administrim shtetëror, komunal dhe privat, si pyje, tokë pyjore, kullota, livadhe dhe të tjera, objekt i veprimit të ligjeve nr. 9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" dhe nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor".

4. ZVRPP-ja e rrethit, brenda muajit dhjetor të çdo viti, i dërgon DAMT-së pasqyrën e transaksioneve të tokës bujqësore.

5. DAMT-ja detyrohet që, brenda muajit janar të vitit pasardhës, të dërgojë përmbledhësen e evidencës në nivel qarku dhe të nënndarjes (rrethit) në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, e cila, brenda muajit shkurt të vitit pasardhës, bën përmbledhësen për të gjithë territorin e vendit.

6. DAMT-ja, në mënyrë periodike, detyrohet të dërgojë në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit evidenca dhe informacione, që kanë si objekt kategoritë e resurseve të përcaktuara në këtë ligj.

Lloji dhe përmbajtja e tyre përcaktohen me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.".

Neni 15

Titulli i kreut IV “Sanksione dhe dispozita të fundit” zëvendësohet me titullin “Kundërvajtje administrative, sanksione dhe dispozita të fundit”.

Neni 16

Pas nenit 13 shtohen nenet 14 dhe 15 me këtë përmbajtje:

“Neni 14

1. Sipas këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative:

a) ndërtimet dhe çdo ndryshim i kategorive të tokës bujqësore, në kundërshtim me përcaktimet e pikave 1 e 2 të nenit 11 të këtij ligji;

b) mospasqyrimi dhe mospërditësimi në dokumentacionin kadastral të ndryshimeve të kategorive të resurseve dhe të kategorive të tokës bujqësore, si dhe mosdhënia e informacioneve, sipas përcaktimeve të pikave 3 e 4 të nenit 12 të këtij ligji;

c) mospërgatitja dhe mosdërgimi në kohë i evidencës së gjendjes dhe i ndryshimeve vjetore të kategorisë së resurseve, sipas përcaktimeve të pikave 2, 3, 5 e 6 të nenit 13 të këtij ligji.

2. DAMT-ja e qarkut vendos gjobë:

a) nga 5 000 deri në 50 000 lekë ndaj çdo subjekti për kundërvajtje administrative, të përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni;

b) nga 1 000 deri në 10 000 lekë ndaj drejtuesit të ZMMT-së në komunë dhe/ose bashki për kundërvajtjet administrative, të përcaktuara në shkronjat “b” e “c” të pikës 1 të këtij neni.

3. Struktura përgjegjëse për administrimin e tokave në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit i vendos gjobë nga 10 000 deri në 20 000 lekë drejtorit të DAMT-së së qarkut për mosveprim, në përmbushje të pikës 2 të këtij neni.

4. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit i propozon ministrit përgjegjës, që mbulon veprimtarinë për fondin pyjor dhe kullosor në ministrinë përkatëse, vendosjen e gjobës nga 10 000 deri në 20 000 lekë ndaj drejtorit të drejtorisë rajonale të shërbimit pyjor për kundërvajtjet e përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij neni.

Neni 15

1. Kundërvajtësi, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit, sipas pikës 2 të nenit 14 të këtij ligji, mund të bëjë ankim me shkrim te kryetari i këshillit të qarkut, i cili shqyrton ankimin dhe, brenda 10 ditëve, njofton subjektin ankues.

Kundër vendimit të kryetarit të këshillit të qarkut, subjekti ankues mund t'i drejtohet brenda 30 ditëve gjykatës së rrethit gjyqësor të qarkut.

Ekzekutimi i vendimeve kryhet sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, të ndryshuar.

2. Drejtori i DAMT-së së qarkut, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit të vendimit të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, sipas pikës 3 të nenit 14 të këtij ligji, mund të bëjë ankim me shkrim te Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, i cili e shqyrton ankimin dhe, brenda 10 ditëve, njofton subjektin ankues.

Kundër vendimit të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, subjekti ankues mund t'i drejtohet brenda 30 ditëve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

3. Ministri përgjegjës, që mbulon veprimtarinë për fondin pyjor e kullosor në ministrinë përkatëse shqyrton propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për vendosjen e gjobës, sipas pikës 4 të nenit 14 të këtij ligji, dhe vendos për ekzekutimin e saj.

Kundërvajtësit mund të ankohen kundër këtij vendimi brenda 30 ditëve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.”.

Neni 17

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 10, 12 e 13 të këtij ligji.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6501, datë 12.4.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr.10 258, datë 25.3.2010

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10 119, DATË 23.4.2009 "PËR PLANIFIKIMIN E TERRITORIT"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 21 shtohet pika 21/1 me këtë përmbajtje:
"21/1. "Zona kombëtare" janë zona, të cilat njësohen ose lidhen me interesa publikë kombëtarë, që ndikojnë ose ndikohen nga zhvillimi dhe ruajtja e territorit.".

Neni 2

Në nenin 8, pas shkronjës "ç" shtohet shkronja "d" me këtë përmbajtje:
"d) miraton kërkesat për zhvillim dhe lejet e ndërtimit në:
i) zona kombëtare;
ii) prona shtetërore të patransferuara te njësitë e qeverisjes vendore;
iii) oborre që përdoren për shërbime të ofruara nga shteti për arsimin dhe shëndetësinë.".

Neni 3

Pas nenit 8 shtohet neni 8/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 8/1

1. Këshilli Kombëtar i Territorit është autoriteti përgjegjës, që ka kompetencë ekskluzive shqyrtimin përfundimtar të planeve zhvillimore dhe rregulluese të bashkive të kategorisë së parë, në territorin e vendit dhe miratimin e tyre.
2. Këshilli Kombëtar i Territorit e ushtron këtë përgjegjësi edhe në territore administrative të tjera, vetëm ku parashikohet zhvillimi i porteve të hapura ndërkombëtare, i centraleve energjetike, digave dhe dambave të larta, si dhe ndërtimeve të tjera me interesa strategjikë për vendin.

3. Në kuptim të këtij neni, bashki të kategorisë së parë janë: Tirana, Shkodra, Durrësi, Elbasani, Fieri, Vlora, Saranda, Gjirokastra, Berati, Pogradeci, Korça, Lezha, Lushnja, Kukësi, Peshkopia, Laçi, Kamza dhe Kavaja.”.

Neni 4

Në nenin 74, në fund të pikës 8 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Në rastet kur zhvillimi është projektuar në zona kombëtare, në prona shtetërore të patransferuara te njësitë e qeverisjes vendore dhe në oborre që përdoren për shërbime që ofrohen nga shteti për arsimin dhe shëndetësinë, kërkesa për zhvillim i përcillet për miratim KKT-së.”.

Neni 5

Në nenin 75, në fund të pikës 1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Në të njëjtën mënyrë, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore ose zyrtari i autorizuar prej tij shpall vendimin e marrë nga KKT-ja për rastet e përcaktuara në paragrafin e fundit të pikës 8 të nenit 74.”.

Neni 6

Në nenin 77, në fund të pikës 2 shtohen 2 paragrafë me këtë përmbajtje:

Lejet e ndërtimit në zona kombëtare dhe në prona shtetërore të patransferuara te njësitë e qeverisjes vendore miratohen nga KKT-ja.

Lejet e ndërtimit në oborre që përdoren për shërbime që ofrohen nga shteti për arsimin dhe shëndetësinë, për ndërtime me karakter jopublik, miratohen nga KKT-ja.”.

Neni 7
Dispozitë kalimtare

Brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, bashkitë e kategorisë së parë, të parashikuara në pikën 3 të nenit 2 të këtij ligji, depozitojnë për shqyrtim planet zhvillimore rregulluese, kur planet nuk i janë nënshtruar shqyrtimit dhe miratimit nga KRRTRSH-ja, sipas ligjit nr.8405, datë 16.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6502, datë 12.4.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr.10 259, datë 1.4.2010

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES FINANCIARE SHTESË PËR MARRËVESHJEN E PROJEKTIT TË FINANCIMIT, DATË 6.2.2007, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË E NDËRMARRJES SË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE, POGRADEC DHE BANKËS GJERMANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (KFW) PËR PROGRAMIN E MBROJTJES MJEDISORE TË LIQENIT TË OHRIT "KANALIZIMET, POGRADEC II""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja financiare shtesë për marrëveshjen e projektit dhe të financimit, datë 6.2.2007, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë e Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve, Pogradec dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW) për programin e mbrojtjes mjedisore të liqenit të Ohrit "Kanalizimet, Pogradec II"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6503, datë 12.4.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE FINANCIARE SHTESË

PËR MARRËVESHJEN E PROJEKTIT DHE FINANCIMIT TË DATËS 6.2.2007 NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ("MARRËSI"), PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, TIRANË DHE UJËSJELLËS-KANALIZIME POGRADEC, AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT
për 300 000 euro
Programi i mbrojtjes mjedisore të liqenit të Ohrit
Ujësjellës-kanalizime Pogradec II

Në bazë të një shkëmbimi notash që ende nuk është kryer midis Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi bashkëpunimin financiar (Shkëmbim notash), Marrësi, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja nëpërmjet kësaj bien dakord për Marrëveshjen e mëposhtme financiare shtesë.

Seksioni 1
Modifikimet e Marrëveshjes së projektit dhe financimit

Dispozitat e mëposhtme të marrëveshjes financiare të datës 6.2.2007, për shumën prej 5 000 000 eurosh do të ndryshojnë si më poshtë:

b)Neni 1.1, fjalia 1

"KfW-ja do t'i japë Marrësit një kontribut financiar që nuk tejkalon 5 800 000 euro dhe Marrësi do të sigurojë kontributin e vet shtesë në shumën 940 000 euro.

c) Neni 1.2 fjalia 1

"Marrësi duhet t'ia transferojë të plotë kontributin financiar dhe kontributin e vet financiar Agjencisë së Zbatimit të Projektit, në përputhje me kushtet e parashtruara në nenin 2."

d) Neni 3.2

"KfW-ja ka të drejtën e refuzimit të kryerjes së rimbursimeve pas datës 31.12.2011".

Seksioni 2

Vlefshmëria e pandërprerë e marrëveshjes së financimit dhe marrëveshjes së veçantë

Të gjitha klauzolat e tjera të Marrëveshjes së projektit dhe të financimit të datës 6.2.2007 do të mbeten të pandryshuara. Pavarësisht kostos totale të rritur të projektit në përputhje me këtë Marrëveshje financiare shtesë sipas kluzolës 1.3 dhe aneksit nr.4 të marrëveshjes së veçantë, të gjitha dispozitat e tjera të marrëveshjes së veçantë datë 6.2.2007 do të mbeten të pandryshuara.

Seksioni 3

Hyrja në fuqi dhe përfundimi i kësaj Marrëveshjeje

3.1 Kjo Marrëveshje shtesë financimi nuk do të hyjë në fuqi derisa shkëmbimi i notave, mbi të cilën është mbështetur të ketë përfunduar.

3.2 Marrëdhëniet ligjore të vendosura nga kjo Marrëveshje shtesë financimi midis KfW-së dhe Marrësit do të përfundojnë me mbarimin e kohës së duhur për projektin, por jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

Bërë në tri kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main
me datë
KfW

Tiranë
me datë
Ministria e Financave
Pogradec
me datë
UK Pogradec

LIGJ
Nr.10 260, datë 1.4.2010

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE "PËR HEQJEN E ANIJEVE TË MBYTURA"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën ndërkombëtare "Për heqjen e anijeve të mbytura".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6504, datë 12.4.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

KONVENTA NDËRKOMBËTARE
MBI HEQJEN E ANIJEVE TË MBYTURA
(Nairobi, 18 maj 2007)

HYRJE

Shtetet palë në këtë Konventë,

të ndërgjegjshme për faktin që anijet e mbytura, nëse nuk hiqen, mund të paraqesin një rrezik për lundrimin ose për mjedisin detar,

të bindura për nevojën e miratimit të rregullave dhe procedurave të njëjtësuara ndërkombëtare për të siguruar heqjen e menjëhershme dhe efikase të anijeve të mbytura dhe pagimin e dëmshpërblimeve për kostot që kjo përfshin,

duke vërejtur se shumë anije të mbytura mund të gjenden në territorin e shteteve, duke përfshirë këtu edhe detin territorial,

duke njohur përfitimet që vijnë nga uniformiteti në regjimet juridike që rregullojnë përgjegjësinë dhe detyrimet për heqjen e anijeve të mbytura të rrezikshme,

duke pasur në mendje rëndësinë e Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën e Detit, të arritur në Montego Bay, më 10 dhjetor 1982, si edhe të drejtën zakonore ndërkombëtare të detit dhe nevojën vijuese për ta vënë në jetë këtë Konventë në përputhje me këto dispozita,

kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1
Përkufizime

Për qëllime të kësaj Konvente:

1. "Zonë e Konventës" nënkupton zonën ekonomike ekskluzive të një shteti palë, të përcaktuar në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, ose nëse një shtet nuk e ka përcaktuar këtë zonë, një zonë përtej dhe përgjatë detit territorial të atij shteti në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe që shtrihet jo më shumë se 200 milje detare nga vijat bazë prej të cilave matet gjerësia e detit të tij territorial.

2."Anije" nënkupton një mjet detar të çfarëdolloji dhe përfshin varkat me fletë të nënujshme, mjetet me jastëkë ajri, ato të zhytshme, mjetet dhe platformat pluskuese, përveçse kur këto platforma janë në vendndodhje të përfshira në gjetjen, shfrytëzimin ose prodhimin e burimeve minerale të shtratit nënujor.

3. "Fatkeqësi detare" nënkupton një përplasje të anijeve me njëra – tjetrën, përplasje me shkëmbinjtë apo incident lundrimi apo ndodhi të tjera në bordin e një anijeje apo nga jashtë saj, që sjellin si rrjedhojë një dëm material apo kërcënim të afërt për dëm material ndaj anijes apo ngarkesës së saj.

4. "Anije e mbytur" si rrjedhim i një fatkeqësie detare nënkupton:

a) një anije të fundosur apo të ngecur; ose

b) cilëndo pjesë të një anijeje të fundosur apo të ngecur, duke përfshirë këtu cilindo send që është apo ka qenë në bordin e kësaj anijeje; ose

c) cilindo send që humbet në det nga një anije që është e ngecur, e fundosur ose e humbur në det; ose

d) një anije që është gati, ose në mënyrë të arsyeshme mund të pritet që të mbytet ose të ngecë, kur nuk janë marrë tashmë masa efikase për ta ndihmuar anijen apo cilëndo pronë në rrezik.

5. "Rrezik" nënkupton çdo kusht apo kërcënim që:

a) paraqet një rrezik për ndalimin e lundrimit; ose

b) mund në mënyrë të arsyeshme të pritet që të sjellë si rrjedhojë pasoja shumë të dëmshme ndaj mjedisit detar, ose dëmtime të vijës bregdetare apo interesave të lidhura me to të një ose më shumë shteteve.

6. "Interesa të lidhura me to" nënkupton interesat e një shteti bregdetar që preken drejtpërdrejt apo që kërcënohen nga një anije e mbytur, të tilla si:

a) veprimtaritë e bregut detar, porteve dhe grykëderdhjeve, duke përfshirë këtu veprimtaritë e peshkimit, që përbëjnë mjete thelbësore jetese për personat e interesuar;

b) pikat tërheqëse turistike dhe interesa të tjerë ekonomikë të zonës në fjalë;

c) shëndetin e popullsisë bregdetare dhe mirëqenien e zonës së interesuar, përfshirë këtu ruajtjen e burimeve të gjalla ujore dhe jetës së egër (faunës); dhe

d) infrastrukturën nënujore dhe detare.

7. “Heqje” nënkupton cilëndo formë të parandalimit, pakësimit apo zhdukjes së rrezikut të krijuar nga një anije e mbytur. “Heq”, “hequr” dhe “duke hequr” do të interpretohen në këtë frymë.

8. “Pronar i regjistruar” nënkupton personin apo personat e regjistruar si pronarë të anijes ose në mungesë të regjistrimit, personin apo personat që zotërojnë anijen në kohën e fatkeqësisë detare. Sidoqoftë, në rastin e një anijeje të zotëruar nga një shtet dhe të operuar nga një shoqëri e cila është e regjistruar në atë shtet si operuese e anijes, “pronar i regjistruar” do të nënkuptojë këtë shoqëri.

9. “Operues i anijes” nënkupton pronarin e anijes ose çdo organizatë apo person tjetër si administratori ose qiramarrësi i anijes, i cili ka marrë përsipër përgjegjësinë për operimin e anijes dhe që, duke marrë përsipër këtë përgjegjësi, ka rënë dakord që të marrë përsipër të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë e përcaktuara sipas Kodit Ndërkombëtar të Administrimit të Sigurisë, të ndryshuar.

10. “Shtet i prekur” nënkupton shtetin në zonën e Konventës të të cilit ndodhet anija e mbytur.

11. “Shteti i regjistrit të anijes” nënkupton, në lidhje me një anije të regjistruar, shtetin e regjistrimit të anijes dhe në lidhje me një anije të paregjistruar, shtetin, flamurin e të cilit ka të drejtë të mbajë anija.

12. “Organizatë” nënkupton Organizatën Ndërkombëtare Detare.

13. “Sekretar i përgjithshëm” nënkupton sekretarin e përgjithshëm të Organizatës Ndërkombëtare Detare.

Neni 2

Synime dhe parime të përgjithshme

1. Një shtet palë mund të marrë masa në përputhje me këtë Konventë në lidhje me heqjen e një anijeje të mbytur që paraqet rrezik në zonën e Konventës.

2. Masat e marra nga shteti i prekur në përputhje me paragrafin 1 do të jenë në përpjesëtim me rrezikun.

3. Masa të tilla nuk mund të shkojnë përtej asaj që është mjaft e nevojshme për të hequr anijen e mbytur që paraqet një rrezik dhe do të pushojnë sapo anija të jetë hequr; ato nuk do të ndërhyjnë në mënyrë të panevojshme në të drejtat dhe interesat e shteteve të tjera, përfshirë këtu shtetin e regjistrit të anijes, si edhe në ato të çdo personi të interesuar, qoftë person fizik apo shoqëri.

4. Zbatimi i Konventës brenda zonës së Konventës nuk do t’i japë të drejtë një shteti palë për të pretenduar apo ushtruar sovranitet apo të drejta sovrane mbi cilëndo pjesë të detit të hapur.

5. Shtetet palë do të bëjnë përpjekje të bashkëpunojnë kur pasojat e një fatkeqësie detare që çojnë në një anije të mbytur përfshijnë një shtet të ndryshëm nga shteti i prekur.

Neni 3

Qëllimi i aplikimit

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Konventë, kjo Konventë do të zbatohet për anijet e mbytura në zonën e Konventës.

2. Një shtet palë mund ta shtrijë zbatimin e kësaj Konvente për anijet e mbytura që gjenden brenda territorit të tij, duke përfshirë detin territorial, duke iu nënshtruar dispozitave të nenit 4, paragrafi 4. Në këtë rast, ai do të njoftojë për këtë sekretarin e përgjithshëm, në kohën e shprehjes së pëlqimit të tij për t’iu nënshtruar kësaj Konvente apo në çdo kohë të mëvonshme. Kur një shtet palë ka bërë më parë një njoftim për ta zbatuar këtë Konventë për anijet e mbytura të ndodhura brenda territorit të tij, duke përfshirë detin e tij territorial, kjo nuk do të ndikojë në të drejtat dhe detyrimet e atij shteti që të marrë masa në lidhje me anijet e mbytura që ndodhen në territorin e tij, të ndryshme nga identifikimi, shënimi dhe heqja në përputhje me këtë Konventë. Dispozitat e neneve 10, 11 dhe 12 të kësaj Konvente nuk do të zbatohen për çfarëdo masash të marra në këtë mënyrë të ndryshme nga ato të referuara në nenet 7, 8 dhe 9 të kësaj Konvente.

3. Kur një shtet palë ka bërë një njoftim sipas paragrafit 2, “zona e konventës” e shtetit të prekur do të përfshijë territorin e atij shteti palë. Duke përfshirë këtu edhe detin territorial.

4. Një njoftim i bërë sipas paragrafit 2 më lart do të hyjë në fuqi për atë shtet palë, nëse është bërë përpara hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për vetë atë shtet palë, pas hyrjes në fuqi. Nëse njoftimi është bërë pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për vetë atë shtet palë, atëherë ai do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas marrjes së tij nga sekretari i përgjithshëm.

5. Një shtet palë që ka bërë një njoftim sipas paragrafit 2, mund ta tërheqë atë në çdo kohë me anë të një njoftimi për tërheqjen drejtuar sekretarit të përgjithshëm. Ky njoftim për tërheqje do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas marrjes së tij nga sekretari i përgjithshëm, përveçse kur vetë njoftimi parashikon një datë më të vonshme.

Neni 4
Përjashtime

1. Kjo Konventë nuk do të zbatohet ndaj masave të marra sipas Konventës Ndërkombëtare në lidhje me ndërhyrjet në det të hapur në rastet e fatkeqësive që shkaktojnë ndotje nga karburantet të vitit 1969, i ndryshuar, ose protokollit në lidhje me ndërhyrjet në det të hapur në rastet e ndotjes nga lëndë të tjera të ndryshme nga karburantet të vitit 1973, i ndryshuar.

2. Kjo Konventë nuk do të zbatohet ndaj cilësdo anije lufte ose anije tjetër të zotëruar apo të operuar nga një shtet dhe të përdorur, për kohën në vazhdim, vetëm për shërbime qeveritare jo-tregtare, përveçse kur ai shtet vendos ndryshe.

3. Kur një shtet palë vendos që ta zbatojë këtë Konventë ndaj anijeve të tij të luftës apo ndaj anijeve të tjera siç përshkruhet në paragrafin 2, ai do ta njoftojë sekretarin e përgjithshëm duke përcaktuar me hollësi në këtë njoftim edhe kushtet dhe afatet e këtij zbatimi.

4. a) Kur një shtet palë ka bërë një njoftim sipas nenit 3, paragrafit 2, dispozitat e mëposhtme të kësaj Konvente nuk do të zbatohen në territorin e tij, duke përfshirë këtu edhe detin territorial:

i) Neni 2, paragrafi 4;

ii) Neni 9, paragrafët 1, 5, 7, 8, 9 dhe 10;

iii) Neni 15.

b) Neni 9, paragrafi 4, për aq sa zbatohet në territorin, duke përfshirë këtu detin territorial, të një shteti palë, do të lexojë:

"Duke iu nënshtruar ligjeve të brendshme të shtetit të prekur, pronari i regjistruar mund të kontraktojë me cilëndo anije shpëtimi apo person tjetër për të hequr anijen e mbytur që është përcaktuar se përbën një rrezik, në emër të pronarit. Përpara se të fillojë një heqje e tillë, shteti i prekur mund të vendosë kushte për këtë heqje vetëm për aq sa është e nevojshme për të siguruar që heqja do të vazhdojë në një mënyrë që është në përputhje me kushtet e sigurisë dhe mbrojtjen e mjedisit detar".

Neni 5
Raportimi mbi anijet e mbytura

1. Një shtet palë do t'i kërkojë kapitenit dhe operuesit të një anijeje që mban flamurin e tij që t'i raportojë shtetit të prekur pa vonesë kur ajo anije është përfshirë në një fatkeqësi detare që ka sjellë si rrjedhojë një anije të mbytur. Për aq sa detyrimi për raportim sipas këtij neni është përmbushur qoftë nga kapiteni, qoftë nga operuesi i anijes, tjetri nuk do të ketë detyrim për të raportuar.

2. Këto raporte do të përmbajnë emrin dhe vendin kryesor të punës së pronarit të regjistruar dhe të gjithë informacionin përkatës të nevojshëm për shtetin e prekur që të përcaktojë nëse anija e mbytur përbën rrezik në përputhje me nenin 6, duke përfshirë:

a) vendndodhjen e saktë të anijes së mbytur;

b) llojin, përmasën dhe ndërtimin e anijes;

c) natyrën e dëmtimit të anijes dhe gjendjen e saj;

d) natyrën dhe sasinë e ngarkesës, në veçanti çfarëdo lëndësh të rrezikshme dhe helmuese; dhe

e) shumën dhe llojet e karburantit, përfshirë këtu karburantin e depozitave dhe lubrifikantët, që gjenden në bord.

Neni 6
Përcaktimi i rrezikut

Shteti i prekur, kur përcakton nëse një anije e mbytur përbën rrezik, duhet të mbajë parasysh kriteret në vijim:

a) llojin, përmasën dhe ndërtimin e anijes;

b) thellësinë e ujit në atë zonë;

c) amplitudën e baticës (valës) dhe rrymat në atë zonë;

d) zona detare veçanërisht të ndjeshme të identifikuara dhe kur është e përshtatshme, të përcaktuara në përputhje me udhëzimet e miratuara nga organizata, ose një pjesë e përcaktuar qartë e zonës ekskluzive ekonomike ku janë marrë masa të posaçme të detyrueshme në zbatim të nenit 211, paragrafi 6 të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën e Detit të vitit 1982;

e) afërsinë me rrugët detare apo linjat e përcaktuara të trafikut;

f) dendësinë dhe shpeshtësinë e trafikut;

g) llojin e trafikut;

h) natyrën dhe sasinë e ngarkesës së anijes së mbytur, shumën dhe llojet e karburantit (të tilla si karburanti i depozitave dhe lubrifikantët) që gjenden në bordin e anijes dhe veçanërisht dëmin që ka të ngjarë të vijë si rrjedhojë nëse ngarkesa apo karburanti do të bjerë në mjedisin detar;

i) dobësitë e mjediseve të porteve;

j) kushtet sunduese meteorologjike dhe hidrografike;

k) topografinë nënujore të zonës;

l) lartësinë e anijes së mbytur mbi apo nën sipërfaqen e ujit në valën (baticën) më të ulët astronomike;

m) profilet magnetike dhe akustike të anijes së mbytur;

n) afërsinë me instalimet nënujore, tubacionet, kabllot e telekomunikacionit dhe struktura të ngjashme; dhe

o) çfarëdo rrethanash të tjera që mund të bëjnë të nevojshme heqjen e anijes.

Neni 7

Përcaktimi i vendndodhjes së anijeve të mbytura

1. Pasi mëson mbi një anije të mbytur, shteti i prekur do të përdorë të gjitha mjetet e praktikueshme, përfshirë këtu shërbimet dashamirëse të shteteve dhe organizatave, për të lajmëruar detarët dhe shtetet e interesuara mbi natyrën dhe vendndodhjen e anijes së mbytur si çështje urgjente.

2. Nëse shteti i prekur ka arsye të besojë se anija e mbytur paraqet rrezik, ai do të sigurojë që të ndërmerren të gjitha hapat e praktikueshme për të përcaktuar vendndodhjen e saktë të anijes së mbytur.

Neni 8

Shënimi i anijeve të mbytura

1. Nëse shteti i prekur përcakton se një anije e mbytur përbën rrezik, ai shtet do të sigurojë që të ndërmerren të gjitha hapat e arsyeshëm për të shënuar anijen e mbytur.

2. Në shënimin e anijes së mbytur do të merren të gjitha hapat e praktikueshëm për të siguruar që shënimet janë në përputhje me sistemin e pranuar ndërkombëtarisht të shënimit me bova pluskuese aktualisht në përdorim, në zonën ku ndodhet anija e mbytur.

3. Shteti i prekur do të shpallë hollësitë e shënimit të anijes së mbytur duke përdorur të gjitha mjetet e përshtatshme, përfshirë këtu publikimet me natyrë nautike.

Neni 9

Masat për të lehtësuar heqjen e anijeve të mbytura

1. Nëse shteti i prekur përcakton se një anije e mbytur përbën rrezik, ai shtet do të:

a) informojë menjëherë shtetin e regjistrit të anijes dhe pronarin e regjistruar; dhe

b) vazhdojë të këshillohet me shtetin e regjistrit të anijes dhe shtetet e tjera të prekura nga anija e mbytur në lidhje me masat që duhen marrë në lidhje me anijen e mbytur.

2. Pronari i regjistruar heq anijen që përcaktohet se përbën rrezik.

3. Kur është përcaktuar se një anije e mbytur përbën rrezik, pronari i regjistruar ose një palë tjetër e interesuar, i siguron autoritetit kompetent të shtetit të prekur prova mbi sigurimin dhe garancitë e tjera financiare siç kërkohen nga neni 12.

4. Pronari i regjistruar mund të kontraktojë me cilëndo anije shpëtimi apo person tjetër për të hequr anijen e mbytur që është përcaktuar se përbën një rrezik, në emër të pronarit. Përpara se të fillojë një heqje e tillë, shteti i prekur mund të vendosë kushte për këtë heqje vetëm për aq sa është e nevojshme

për të siguruar që heqja do të vazhdojë në një mënyrë që është në përputhje me kushtet e sigurisë dhe mbrojtjen e mjedisit detar.

5. Kur heqja tek e cila bëhet referim në paragrafët 2 dhe 4 ka filluar, shteti i prekur mund të ndërhyjë gjatë heqjes vetëm për aq sa është e nevojshme për të siguruar që heqja do të vazhdojë në një mënyrë efikase që është në përputhje me kushtet e sigurisë dhe mbrojtjen e mjedisit detar.

6. Shteti i prekur:

a) do të vendosë një afat të arsyeshëm brenda të cilit pronari i regjistruar duhet të heqë anijen e mbytur duke marrë parasysh natyrën e rrezikut të përcaktuar në përputhje me nenin 6;

b) do ta informojë pronarin e regjistruar me shkrim mbi këtë afat që ai ka caktuar dhe do të përcaktojë me hollësi që, nëse pronari i regjistruar nuk e heq anijen e mbytur brenda atij afati, ai mund ta heqë anijen e mbytur me shpenzimet e pronarit të regjistruar; dhe

c) do ta informojë pronarin e regjistruar me shkrim se ai ka qëllim të ndërhyjë menjëherë në rrethanat kur rreziku bëhet veçanërisht i afërt.

7. Nëse pronari i regjistruar nuk e heq anijen brenda afatit të përcaktuar në përputhje me paragrafin 6 (a) ose nëse pronari i regjistruar nuk mund të kontaktohet, shteti i prekur mund ta heqë anijen e mbytur me mjetet më praktike dhe të shpejta të mundshme, në përputhje me kushtet e sigurisë dhe mbrojtjen e mjedisit detar.

8. Në rrethanat kur kërkohet veprim i menjëhershëm dhe shteti i prekur ka informuar në mënyrën e duhur shtetin e regjistrit të anijes dhe pronarin e anijes, ai mund ta heqë anijen e mbytur me mjetet më praktike dhe të shpejta të mundshme, në përputhje me kushtet e sigurisë dhe mbrojtjen e mjedisit detar.

9. Shtetet palë do të ndërmarrin masat e përshtatshme në ligjet e tyre të brendshme për të siguruar që pronarët e tyre të regjistruar të veprojnë në përputhje me paragrafët 2 dhe 3.

10. Shtetet palë ia japin pëlqimin e tyre shtetit të prekur që të veprojë sipas paragrafëve nga 4 deri në 8, kur kërkohet.

11. Informacioni i referuar në këtë nen do t'i jepet nga shteti i prekur pronarit të regjistruar, të identifikuar në raportimet e referuara në nenin 5, paragrafi 2.

Neni 10

Përgjegjësia e pronarit

1. Duke iu nënshtruar nenit 11, pronari i regjistruar është përgjegjës për kostot e identifikimit, shënimit dhe heqjes së anijes së mbytur sipas përkatësisht neneve 7, 8 dhe 9, përveçse kur pronari i regjistruar provon se fatkeqësia detare që shkaktoi anijen e mbytur:

a) ishte rrjedhojë e një veprimi lufte, veprimi ushtarak, lufte civile, kryengritje ose një fenomen natyror i një karakteri përjashtimor, të pashmangshëm dhe të papërballueshëm;

b) u shkaktua tërësisht nga një veprim apo mosveprim i bërë nga një palë e tretë me qëllimin për të shkaktuar dëm; ose

c) u shkaktua tërësisht nga pakujdesia apo veprime të tjera të gabuara të cilësdo qeveri apo autoritet tjetër përgjegjës për mirëmbajtjen e ndriçimeve dhe ndihmesave të tjera lundruese në ushtrimin e atij funksioni.

2. Asgjë në këtë Konventë nuk do të prekë të drejtën e pronarit të regjistruar për ta kufizuar përgjegjësinë sipas cilitdo regjim të zbatueshëm të brendshëm apo ndërkombëtar, të tillë si konventa për kufizimin e përgjegjësisë për pretendimet detare e vitit 1976, e ndryshuar.

3. Asnjë pretendim për kostot e referuara në paragrafin 1 nuk mund të ngrihet kundër pronarit të regjistruar ndryshe nga sa parashikohet në dispozitat e kësaj Konvente. Kjo nuk prek të drejtat dhe detyrimet e një shteti palë i cili ka bërë një njoftim sipas nenit 3, paragrafi 2, në lidhje me anijet e mbytura që gjenden në territorin e tij, përfshirë këtu detin territorial, të ndryshme nga identifikimi, shënimi dhe heqja në përputhje me këtë Konventë.

4. Asgjë në këtë Konventë nuk do të prekë çfarëdo të drejte për ankim kundër palëve të treta.

Neni 11

Përjashtimet nga përgjegjësia

1. Pronari i regjistruar nuk do të jetë përgjegjës sipas kësaj Konvente për kostot e përmendura në nenin 10, paragrafi 1 nëse, dhe për aq sa përgjegjësia për këto kosto nuk është në kundërshtim me:

a) Konventën ndërkombëtare për përgjegjësinë civile për dëmet nga ndotja e shkaktuar nga karburantet, të vitit 1969, i ndryshuar;

b) Konventën ndërkombëtare për përgjegjësinë dhe dëmshpërblimin për dëmet në lidhje me transportimin e lëndëve të rrezikshme dhe helmuese me rrugë detare, të vitit 1996, i ndryshuar;

c) Konventën mbi përgjegjësinë e palëve të treta në fushën e energjisë bërthamore, të vitit 1960, i ndryshuar, ose konventën e Vjenës mbi përgjegjësinë civile për dëmtimet bërthamore, të vitit 1963, i ndryshuar; ose të drejtën e brendshme që rregullon apo ndalon kufizimin e përgjegjësisë për dëmtimet bërthamore; ose

d) Konventën ndërkombëtare mbi përgjegjësinë civile për dëmet nga ndotja e shkaktuar nga karburanti i depozitave, të vitit 2001, i ndryshuar; me kusht që konventa përkatëse të jetë e zbatueshme dhe në fuqi.

2. Për aq sa masat sipas kësaj Konvente konsiderohen se janë masa shpëtimi sipas ligjit të brendshëm ose sipas një konvente ndërkombëtare të zbatueshme, ky ligj apo kjo konventë ndërkombëtare do të zbatohet ndaj çështjeve të shpërblimit apo dëmshpërblimit të pagueshëm ndaj anijeve të shpëtimit duke përjashtuar rregullat e kësaj Konvente.

Neni 12

Sigurimi i detyrueshëm apo garanci të tjera financiare

1. Pronarit të regjistruar të një anijeje me tonazh bruto 300 ose më shumë ton dhe që mban flamurin e një shteti palë do t'i kërkohet që të ketë një sigurim ose garanci të tjera financiare të tilla, si garanci nga një bankë apo institucion i ngjashëm, për të mbuluar përgjegjësitë sipas kësaj Konvente në një shumë të barabartë me kufijtë e përgjegjësisë sipas regjimit të zbatueshëm kufizues të brendshëm apo ndërkombëtar, por që në çdo rast nuk kalon shumën e llogaritur, në përputhje me nenin 6(1)(b) të konventës mbi kufizimin e përgjegjësisë për pretendimet detare të vitit 1976, i ndryshuar.

2. Një certifikatë që vërteton se sigurimi apo garancia tjetër financiare është në fuqi, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, do të lëshohet për cilëndo anije me tonazh bruto 300 ose më shumë ton nga autoriteti përkatës i shtetit të regjistrit të anijes, pasi të përcaktohet se janë plotësuar kërkesat e paragrafit 1. Në lidhje me një anije të regjistruar në një shtet palë, kjo certifikatë do të lëshohet apo vërtetohet nga autoriteti përkatës i shtetit të regjistrit të anijes; në lidhje me një anije që nuk është e regjistruar në një shtet palë, ajo mund të lëshohet apo vërtetohet nga autoriteti përkatës i cilitdo shtet palë. Kjo certifikatë e detyrueshme sigurimi do të jetë në formën e modelit të dhënë në shtojcën e kësaj Konvente dhe do të përmbajë hollësitë në vijim:

a) emrin e anijes, numrin apo shkronjat dalluese dhe portin e regjistrimit;

b) tonazhin bruto të anijes;

c) emrin dhe vendin kryesor të punës së pronarit të regjistruar;

d) numrin e identifikimit të anijes sipas Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO);

e) llojin dhe kohëzgjatjen e sigurimit;

f) emrin dhe vendin kryesor të punës së siguruesit apo personit tjetër që jep sigurimin dhe kur është e përshtatshme, vendin e punës ku është vendosur sigurimi apo garancia;

g) periudhën e vlefshmërisë së certifikatës e cila nuk do të jetë më e gjatë sesa periudha e vlefshmërisë së sigurimit apo garancisë tjetër.

3. a) Një shtet palë mund të autorizojë ose një institucion ose një organizatë të njohur nga vetë ai që të lëshojë certifikatën e referuar në paragrafin 2. Ky institucion ose organizatë do ta informojë atë shtet mbi lëshimin e çdo certifikate. Në të gjitha rastet, shteti palë do të garantojë plotësisht plotësinë dhe saktësinë e certifikatës së lëshuar në këtë mënyrë dhe do të marrë përsipër që të sigurojë kryerjen e rregullimeve të nevojshme për ta përmbushur këtë detyrim.

b) Një shtet palë do të njoftojë sekretarin e përgjithshëm mbi:

i) përgjegjësitë dhe kushtet e posaçme të autoritetit që i ka deleguar një institucioni apo organizate të njohur nga vetë ai;

ii) heqjen e këtij autoriteti; dhe

iii) datën nga e cila merr fuqi ky autoritet apo heqja e këtij autoriteti.

Një autoritet i deleguar nuk do të hyjë në fuqi përpara tre muajve nga data në të cilën njoftimi për këtë qëllim i është dhënë sekretarit të përgjithshëm.

c) Institucioni ose organizata e autorizuar për të lëshuar certifikata në përputhje me këtë paragraf, si minimum, do të jetë i autorizuar t'i tërheqë këto certifikata nëse nuk ruhen kushtet sipas të cilave ato janë lëshuar. Në të gjitha rastet, institucioni apo organizata do të raportojë mbi këto tërheqje tek shteti në emër të të cilit është lëshuar certifikata.

4. Certifikata do të jetë në gjuhën ose gjuhët zyrtare të shtetit lëshues. Nëse gjuha e përdorur nuk është anglisht, frëngjisht ose spanjisht, teksti do të përfshijë edhe një përkthim në një nga këto gjuhë dhe kur shteti vendos në këtë mënyrë, gjuha (gjuhët) zyrtare të shtetit mund të hiqen.

5. Certifikata do të mbahet në bordin e anijes dhe një kopje do të depozitohet pranë autoriteteve që mbajnë shënimet e regjistrit të anijes ose, nëse anija nuk është e regjistruar në një shtet palë, pranë autoriteteve që lëshojnë ose vërtetojnë certifikatën.

6. Sigurimi ose garancia tjetër financiare nuk do të përmbushë kërkesat e këtij neni, nëse ai mund të pushojë së vepruari për arsye të ndryshme nga mbarimi i periudhës së vlefshmërisë së sigurimit apo garancisë së përcaktuar me hollësi në certifikatë sipas paragrafit 2 përpara se të kenë kaluar tre muaj nga data në të cilën autoriteteve, të referuara në paragrafin 5, u është dhënë njoftimi për përfundimin e tij, përveçse kur certifikata u është dorëzuar këtyre autoriteteve ose kur është lëshuar një certifikatë e re brenda periudhës së dhënë. Dispozitat paraardhëse do të zbatohen njëlloj për çdo ndryshim, të cilat bëjnë që sigurimi apo garancia të mos përmbushin më kushtet e këtij neni.

7. Shteti i regjistrit të anijes, duke iu nënshtruar dispozitave të këtij neni dhe duke mbajtur parasysh çfarëdo udhëzimesh të miratuara nga organizata mbi përgjegjësinë financiare të pronarëve të regjistruar, do të përcaktojë kushtet e lëshimit dhe vlefshmërisë së certifikatës.

8. Asgjë në këtë Konventë nuk do të interpretohet sikur parandalon një shtet palë që të mbështetet mbi informacionin e përftuar nga shtete të tjera apo nga organizata ose nga organizata të tjera ndërkombëtare, në lidhje me gjendjen financiare të ofruesve të sigurimeve apo garancive të tjera financiare për qëllime të kësaj Konvente. Në të tilla raste, shteti palë që mbështetet mbi këtë informacion nuk do të çlirohet nga përgjegjësia e tij si shtet që lëshon certifikatën e kërkuar nga neni 2.

9. Certifikatat e lëshuara dhe të vërtetuara nën autoritetin e një shteti palë do të pranohen nga shtetet e tjera palë për qëllimet e kësaj Konvente dhe do të quhen nga shtetet e tjera palë se kanë të njëjtën fuqi si certifikatat e lëshuara apo vërtetuara nga vetë ato, edhe nëse janë lëshuar apo vërtetuar në lidhje me një anije që nuk është e regjistruar në një shtet palë. Një shtet palë mund të kërkojë në çdo kohë këshillim me shtetin lëshues apo vërtetues, nëse ai beson se siguruesi apo garantuesi i përmendur në certifikatë nuk është i aftë financiarisht të përmbushë detyrimet e vendosura nga kjo Konventë.

10. Çfarëdo pretendimi që lind sipas kësaj Konvente mund të ngrihet drejtpërdrejt kundër siguruesit ose personit tjetër që siguron garanci financiare për përgjegjësinë e pronarit të regjistruar. Në një rast të tillë, i padituri mund të përfitojë nga mjetet mbrojtëse (të ndryshme nga falimentimi apo likuidimi i pronarit të regjistruar) që pronari i regjistruar do të kishte të drejtë të përfitonte, duke përfshirë këtu kufizimin e përgjegjësisë sipas cilitdo regjim të zbatueshëm të brendshëm apo ndërkombëtar. Po kështu, edhe nëse pronari i regjistruar nuk ka të drejtë për kufizime të përgjegjësisë, i padituri mund ta kufizojë përgjegjësinë në një shumë të barabartë me shumën e sigurimit apo garancisë tjetër financiare që kërkohet në përputhje me paragrafin 1. Për më tepër, i padituri mund të përfitojë mbrojtje me arsyetimin se fatkeqësia detare u shkaktua nga drejtimi i keq me dashje i pronarit të regjistruar, por i padituri nuk mund të përfitojë nga asnjë mbrojtje tjetër të cilën i padituri mund ta ketë pasur të drejtë për ta kërkuar në procedimet e ngritura nga pronari i regjistruar kundër të padituri. Në çdo rast, i padituri do të ketë të drejtën t'i kërkojë pronarit të regjistruar që t'i bashkohet atij në këto procedime.

11. Një shtet palë nuk do të lejojë asnjë anije që ka të drejtën të mbajë flamurin e tij ndaj të cilës vepron ky nen, të operojë në çdo kohë, përveçse kur është lëshuar një certifikatë sipas paragrafit 2 ose atij 14.

12. Duke iu nënshtruar dispozitave të këtij neni, secili shtet palë do të sigurojë, sipas së drejtës së tij të brendshme, që sigurimi apo garancia tjetër në masën e kërkuar nga paragrafi 1 të jetë në fuqi për çdo anije që ka një tonazh bruto prej 300 ose më shumë ton, kudo që ajo të jetë e regjistruar, që hyn apo del nga një port në territorin e tij, ose që arrin në apo largohet nga një mjedis në det të hapur në detin e tij territorial.

13. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 5, një shtet palë mund të njoftojë sekretarin e përgjithshëm se, për qëllimet e paragrafit 12, anijeve nuk u kërkohet të mbajnë në bord ose të tregojnë certifikatën e kërkuar nga paragrafi 2, kur hyjnë apo dalin nga një port në territorin e tij, ose që arrijnë

në apo largohen nga një mjedis në det të hapur në detin e tij territorial, me kusht që shteti palë që lëshon certifikatën e kërkuar nga paragrafi 2 të njoftojë sekretarin e përgjithshëm se ai mban regjistra në format elektronik, ku mund të hyjnë të gjitha shtetet palë, që vërteton ekzistencën e certifikatës dhe mundëson shtetet palë që të shkarkojnë përgjegjësitë e tyre sipas paragrafit 12.

14. Nëse sigurimi apo garancia tjetër financiare nuk ruhet në lidhje me një anije të zotëruar nga një shtet palë, dispozitat e këtij neni në lidhje me këtë nuk do të jenë të zbatueshme për këtë anije, por anija do të mbajë një certifikatë të lëshuar nga autoriteti i duhur i shtetit të regjistrit ku të deklarohet se ajo zotërohet nga ai shtet dhe se përgjegjësia e anijes mbulohet brenda kufijve të parashikuar në paragrafin 1. Një certifikatë e tillë do të ndjekë sa më shumë që të jetë e mundur modelin e parashikuar nga paragrafi 2.

Neni 13
Afatet kohore

Të drejtat për të përftuar kostot sipas kësaj Konvente do të shuhen përveçse kur ngrihet një pretendim brenda tre viteve nga data kur është përcaktuar rreziku në përputhje me këtë Konventë. Sidoqoftë, asnjë pretendim nuk mund të ngrihet më, pasi kanë kaluar gjashtë vjet nga data e fatkeqësisë detare që shkaktoi anijen e mbytur. Kur fatkeqësia detare konsiston në një radhë ngjarjesh, periudha gjashtëvjeçare do të fillojë që nga data e ngjarjes së parë.

Neni 14
Dispozitat për ndryshime

1. Me kërkesën e jo më pak se një të tretës së shteteve palë, organizata do të thërrasë një konferencë me qëllimin e rishikimit apo ndryshimit të kësaj Konvente.

2. Cilido pëlqim i dhënë për t'iu nënshtruar kësaj Konvente, i shprehur pas datës së hyrjes në fuqi të një ndryshimi ndaj kësaj Konvente, do të konsiderohet se zbatohet për këtë Konventë siç është ndryshuar.

Neni 15
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Kur ka një mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë shteteve palë në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj Konvente, ato do të përpiqen ta zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre, së pari, përmes negociatave, hetimeve, ndërmjetësimit, pajtimit, arbitrazhit, zgjidhjes gjyqësore, drejtimit tek agjencitë apo marrëveshjet rajonale ose përmes mjeteve të tjera paqësore të zgjedhura prej tyre.

2. Nëse asnjë ndërmjetësim nuk është i mundur brenda një periudhe të arsyeshme kohore që nuk i kalon dymbëdhjetë muaj që kur njëri shtet palë ka njoftuar tjetrin se ekziston një mosmarrëveshje ndërmjet tyre, do të zbatohen *mutatis mutandis* dispozitat e përcaktuara në pjesën XV të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën e Detit të vitit 1982, pavarësisht nëse shtetet pjesë të mosmarrëveshjes janë gjithashtu shtete palë të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën e Detit të vitit 1982, ose jo.

3. Cilado procedurë e zgjedhur nga një shtet palë në këtë Marrëveshje dhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën e Detit të vitit 1982, në zbatim të nenit 287 të kësaj të fundit do të zbatojë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas këtij neni, përveçse kur ai shtet palë, në momentin që ratifikon, pranon, miraton apo futet në këtë Konventë ose në çdo moment të mëvonshëm, zgjedh një procedurë tjetër në përputhje me nenin 287 për qëllimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që dalin nga kjo Konventë.

4. Një shtet palë në këtë Konventë, që nuk është palë në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën e Detit të vitit 1982, në momentin që ratifikon, pranon, miraton apo futet në këtë Konventë ose në çdo moment të mëvonshëm do të jetë i lirë të zgjedhë, përmes një deklarate me shkrim, një apo më shumë nga mjetet e përcaktuara në nenin 287, paragrafi 1 të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën e Detit të vitit 1982, për qëllimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas këtij neni. Neni 287 do të zbatohet për një deklaratë të tillë, si edhe për çdo mosmarrëveshje në të cilën një shtet i tillë është palë, e cila nuk mbulohet nga një deklaratë në fuqi. Për qëllimet e pajtimit dhe

arbitrazhit, në përputhje me shtojcat V dhe VII të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën e Detit të vitit 1982, ky shtet do të ketë të drejtë të emërojë pajtues dhe arbitra për t'u përfshirë në listat e referuara në shtojcën V, neni 2, dhe në shtojcën VII, neni 2, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që dalin nga kjo Konventë.

5. Një deklaratë e bërë sipas paragrafëve 3 dhe 4 do të depozitohet pranë sekretarit të përgjithshëm, i cili do t'u përcjellë kopje të saj shteteve palë.

Neni 16

Marrëdhënia me konventat dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare

Asgjë në këtë Konventë nuk do të prekë të drejtat dhe detyrimet e cilitdo shtet sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën e Detit të vitit 1982, si edhe sipas së drejtës ndërkombëtare zakonore të detit.

Neni 17

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe hyrja

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim në selinë e organizatës nga data 19 nëntor 2007 deri më 18 nëntor 2008 dhe do të mbetet në vijim e hapur për nënshkrim.

a) Shtetet mund të shprehin pëlqimin e tyre për t'iu nënshtruar kësaj Konvente me anë të:

i) nënshkrimit pa rezerva në lidhje me ratifikimin, pranimin ose miratimin; ose

ii) nënshkrimit që i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit të ndjekur nga ratifikimi, pranimi ose miratimi; ose

iii) hyrjes.

b) Ratifikimi, pranimi, miratimi ose hyrja do të kryhet përmes depozitimit të një instrumenti për këtë qëllim pranë sekretarit të përgjithshëm.

Neni 18

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi dymbëdhjetë muaj pas datës në të cilën dhjetë shtete ose ta kenë nënshkruar atë pa rezerva, në lidhje me ratifikimin, pranimin ose miratimin ose të kenë depozituar instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose hyrjes pranë sekretarit të përgjithshëm.

2. Për cilindo shtet, i cili ratifikon, pranon, miraton apo hyn në këtë Konventë, pasi janë plotësuar kushtet e paragrafit 1 për hyrjen në fuqi, kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit nga ky shtet të instrumentit të përshtatshëm, por jo përpara se kjo Konventë të ketë hyrë në fuqi në përputhje me paragrafin 1.

Neni 19

Denoncimi

1. Kjo Konventë mund të denoncohet në çdo kohë nga një shtet palë pas kalimit të një viti nga data në të cilën kjo Konventë ka hyrë në fuqi për atë shtet.

2. Denoncimi do të kryhet përmes depozitimit pranë sekretarit të përgjithshëm të një instrumenti për këtë qëllim.

3. Një denoncim do të hyjë në fuqi një vit pas marrjes së tij nga sekretari i përgjithshëm, ose pas një periudhe më të gjatë siç mund të jetë përcaktuar në instrumentin e denoncimit.

Neni 20

Depozitimi

1. Kjo Konventë do të depozitohet pranë sekretarit të përgjithshëm.

2. Sekretari i përgjithshëm:

a. Do të informojë të gjitha shtetet që kanë e nënshkruar apo kanë hyrë në këtë Konventë mbi:

i) çdo nënshkrim të ri apo depozitim të një instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi apo hyrje, bashkë me datën përkatëse;

ii) datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente;

iii) depozitimin e çfarëdo instrumenti për denoncimin e kësaj Konvente bashkë me datën e depozitimit dhe datën në të cilën denoncimi hyn në fuqi; dhe

iv) deklarata dhe njoftime të tjera të marra në përputhje me këtë Konventë; dhe

b) Do t'u përcjellë kopje të vërtetuara të kësaj Konvente që gjitha shteteve që e kanë nënshkruar apo që kanë hyrë në këtë Konventë.

3. Sapo Konventa të ketë hyrë në fuqi, një kopje e vërtetuar e tekstit do t'i përcillet nga ana e sekretarit të përgjithshëm, Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për regjistrim dhe publikim në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 21

Gjuhët

Kjo Konventë është arritur në një origjinal të vetëm në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, ku secili tekst është njëlloj autentik.

Bërë në Najrobi, në ditën e tetëmbëdhjetë të majit dymijë e shtatë.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar në mënyrën e duhur nga qeveritë e tyre përkatëse për këtë qëllim, nënshkruan këtë Konventë.

SHTOJCË

CERTIFIKATË SIGURIMI APO GARANCIE TJETËR FINANCIARE NË LIDHJE ME PËRGJEGJËSINË PËR HEQJEN E ANIJEVE TË MBYTURA

Lëshuar në përputhje me dispozitat e nenit 12 të Konventës Ndërkombëtare të Najrobit mbi heqjen e anijeve të mbytura, të vitit 2007.

Emri i anijes	Tonazhi bruto	Numri ose shkronjat dalluese	Numri i identifikimit të anijes sipas IMO	Porti i regjistrit	Emri dhe adresa e plotë e vendit kryesor të punës së pronarit të regjistruar

Kjo është për të vërtetuar që, në lidhje me anijen e sipërpërmendur, është në fuqi një policë sigurimi apo garanci tjetër financiare që përmbush kërkesat e nenit 12 të Konventës Ndërkombëtare të Najrobit mbi heqjen e anijeve të mbytura të vitit 2007.

Lloji i sigurimit

……

Kohëzgjatja e sigurimit

……

Emri dhe adresa e siguruesit / siguruesve dhe / ose garantuesit / garantuesve

Emri

……

Adresa

……

Kjo certifikatë është e vlefshme deri më

……

Lëshuar ose vërtetuar nga Qeveria e
……
(Përshkrimi i plotë i Shtetit)

ose

Teksti në vijim duhet të përdoret kur një shtet palë përfiton nga neni 12, paragrafi 3:
Kjo certifikatë lëshohet nga autoriteti i Qeverisë së
……
(Përshkrimi i plotë i shtetit) nga ……
(emri i organizatës apo institucionit)

Në …… me ……
(vendi) (data)

……
(nënshkrimi dhe titulli i zyrtarit lëshues apo vërtetues)

Shënime shpjeguese:

1. Nëse dëshirohet, përshkrimi i shtetit mund të përfshijë një referim tek autoriteti kompetent publik i vendit ku është lëshuar certifikata.

2. Nëse shuma e përgjithshme e sigurimit është dhënë nga më shumë se një burim, duhet të tregohet shuma e secilit prej tyre.

3. Nëse sigurimi është dhënë në disa forma, këto duhet të listohen.

4. Treguesi "Kohëzgjatja e sigurimit" duhet të përcaktojë datën në të cilën hyn në fuqi ky sigurim.

5. Treguesi "Adresa" e siguruesit / siguruesve dhe / ose garantuesit / garantuesve duhet të tregojë vendin kryesor të punës së siguruesit / siguruesve dhe / ose garantuesit / garantuesve. Nëse është e përshtatshme, do të tregohet vendi i punës ku është vendosur sigurimi ose garancia tjetër.

LIGJ
Nr.10 261, datë 1.4.2010

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008 "PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 16 "Struktura e administratës tatimore qendrore", në pikën 3, pas shkronjës "e" shtohet shkronja "ë" me këtë përmbajtje:

"ë) Avokati i Tatimpaguesve.".

Neni 2

Pas nenit 38 shtohet neni 38/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 38/1
Këshilli Tatimor si organ këshillimor

1. Pranë Ministrit të Financave krijohet Këshilli Tatimor, si organ këshillimor.

2. Këshilli Tatimor është forum teknik këshillimi dhe bashkëpunimi për dhe ndërmjet Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe tatimpaguesve.

3. Këshilli Tatimor ka për qëllim diskutimin e problematikave dhe propozimin e masave, që do të bënin të mundur zbatimin e legjislacionit tatimor me një kosto më të ulët administrative për administratën tatimore dhe me një kosto më të ulët financiare për tatimpaguesit.

4. Këshilli Tatimor ka këto funksione:

a) shqyrtimin e procedurave të deklarimit e të pagimit të tatimeve, me synim përmirësimin dhe lehtësimin e tyre;

b) shqyrtimin e vështirësive, që hasin tatimpaguesit në plotësimin e të drejtave që parashikohen nga legjislacioni tatimor;

c) propozimin e masave për të garantuar respektimin e të drejtave të tatimpaguesve;

ç) propozimin e ndryshimeve të procedurave, për të mundësuar plotësimin vullnetar të detyrimeve tatimore me një kosto më të ulët administrative për administratën tatimore dhe me një kosto më të ulët financiare për tatimpaguesit;

d) hartimin e materialeve të shkruara të propozimeve për masat që mund të merren për përmirësimin e procedurave të deklarimit e të pagimit vullnetar të tatimeve;

dh) hartimin e materialeve të shkruara të propozimeve për plane konkrete bashkëpunimi, ndërmjet shoqatave profesionale tatimore, shoqatave të biznesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, lidhur me informimin dhe edukimin e tatimpaguesve;

e) organizimin e seminareve e të trajnimeve të përbashkëta për punonjësit e administratës tatimore dhe të organizatave profesionale tatimore të tatimpaguesve.

5. Këshilli Tatimor mund t'i propozojë Ministrit të Financave ndryshime në dispozitat ligjore e nënligjore tatimore, që lidhen me objektin e vet të veprimtarisë.

6. Burimet e financimit të Këshillit Tatimor janë:

a) Buxheti i Shtetit;

b) kontributi i anëtarëve që përfaqësojnë tatimpaguesit;

c) burime të tjera të ligjshme financiare, të dhëna në formë donacioni nga institucione apo nga organizata kombëtare apo ndërkombëtare, për financimin e veprimtarive që lidhen me objektin e vet.

7. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të Këshillit Tatimor, si dhe kontributet financiare të anëtarëve që përfaqësojnë tatimpaguesit në të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 3

Pas nenit 105/1 shtohet neni 105/2 me këtë përmbajtje.

"Neni 105/2
Struktura dhe funksionet e Avokatit të Tatimpaguesve

1. Avokati i Tatimpaguesve mbron interesat e tatimpaguesve në marrëdhëniet me organet tatimore. Ai autorizohet të investigojë të gjitha kërkesat e tatimpaguesve, që përmbajnë probleme të administrimit të tatimeve, si vonesa administrative të paarsyeshme, gabime të zyrtarëve tatimorë, që nuk janë zgjidhur në mënyrën e duhur pas paraqitjes nga tatimpaguesi, mosrespektimi i procedurave tatimore apo shkelje të procedurave tatimore nga zyrtarët tatimorë.

2. Avokati i Tatimpaguesve ka këto funksione:

a) evidentimin, klasifikimin dhe trajtimin e drejtë të çdo ankese të marrë nga tatimpaguesit;

b) bashkëpunimin me drejtorinë e shërbimit të tatimpaguesve, për të promovuar rolin e Avokatit të Tatimpaguesit në mbrojtjen e të drejtave të tatimpaguesit;

c) bashkëpunimin me drejtorinë e kontrollit të brendshëm, me drejtorinë e personelit dhe me drejtoritë e tjera të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për të garantuar që tatimpaguesit të trajtohen apo do të trajtohen në përputhje me dispozitat ligjore dhe se të drejtat e tyre mbrohen dhe respektohen në mënyrën e duhur nga punonjësit e administratës tatimore, në përputhje me Kodin e Etikës;

ç) ndjekjen dhe trajtimin me korrektësi të çdo rasti individual dhe mbylljen e arkivimin e tyre vetëm pasi ankesat të jenë trajtuar e zgjidhur në përputhje me legjislacionin tatimor, dispozitat e Kodit të Etikës dhe udhëzimet e nxjerra në zbatim të dispozitave të këtij kreu;

d) bashkëpunimin me drejtorinë e shërbimit të tatimpaguesve, drejtorinë e trajnimit dhe drejtorinë e personelit, me qëllim që nga përfundimet e nxjerra nga rastet e veçanta në të gjitha drejtoritë rajonale tatimore, të garantohet mospërsëritja e gabimeve;

dh) bërjen e propozimeve zëvendësdrejtorëve të përgjithshëm dhe koordinatorëve rajonalë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për masa administrative ndaj punonjësve të administratës tatimore, të cilët kanë shkelur dispozitat e Kodit të Etikës;

e) referimin e rasteve të veçanta drejtorisë së investigimit të brendshëm ose drejtorisë së investigimit kriminal, nëse informacioni apo dokumentacioni i nxjerrë tregojnë se rasti në fjalë kërkon nisjen e procesit të investigimit administrativ ose kriminal;

ë) bërjen e propozimeve Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve për përmirësime në proceset e punës dhe në procedurat tatimore, si dhe lidhur me dispozitat e Kodit të Etikës, me synim përmirësimin e shërbimeve ndaj tatimpaguesve, reduktimin e barrës administrative dhe lehtësimin e procedurave për tatimpaguesit në përmbushjen e detyrimeve tatimore.

3. Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesve ka si funksion parësor sigurimin e një informacioni efiçent dhe prezantimin në hallkat administrative përkatëse të problemeve e të shqetësimeve të tatimpaguesve, në përmbushjen e detyrimeve tatimore dhe të procedurave përkatëse administrative, si dhe garantimin e plotësimit të të drejtave të tatimpaguesve nga administrata tatimore.

4. Avokati i Tatimpaguesve nuk është i autorizuar të investigojë apo të ndërhyjë në rastet, për të cilat tatimpaguesi është investiguar nga drejtoria e investigimit tatimor apo nga drejtoria e investigimit të brendshëm. Avokati i Tatimpaguesve nuk autorizohet të investigojë apo të ndërhyjë në procesin e përcaktimit të detyrimit tatimor apo për raste, të cilat janë në proces apelimi. Megjithatë, Avokati i Tatimpaguesve është i autorizuar të investigojë dhe të ndërhyjë, nëse procesi i vlerësimit të detyrimeve tatimore apo procesi i apelimit nuk kryhet në përputhje me procedurat e vendosura në ligj apo në dispozitat përkatëse nënligjore. Ky autorizim kufizohet me të drejtën e sigurimit të respektimit të procedurave dhe jo në vendimet lidhur me shumat e vlerësuara të detyrimeve tatimore apo në vendimin e marrë për apelimin.

5. Avokati i Tatimpaguesve emërohet nga Ministri i Financave, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

6. Autoriteti, funksionet e bashkëpunimi i Avokatit të Tatimpaguesve brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe me palët e treta përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. Procedurat e hollësishme për funksionet, përgjegjësitë dhe procedurat që do të zbatohen nga Avokati i Tatimpaguesve, si dhe procedurat që do të ndiqen nga tatimpaguesit, për të përfituar nga shërbimet e ofruara nga Drejtoria e Avokatit të Tatimpaguesve, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

8. Manuali i Avokatit të Tatimpaguesve, i cili duhet të përmbajë procedura të hollësishme dhe proceset e punës për mbledhjen e informacionit, evidentimin dhe përpunimin e ankesave të tatimpaguesve, zgjedhjen dhe trajtimin e ankesave e të shqetësimeve të tatimpaguesve, përgjithësimin e rasteve, mbylljen e rasteve, si dhe treguesit e matjes së performancës së punës dhe procedurat e raportimit, miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6505, datë 12.4.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 20.4.2010
Doli nga shtypi më 21.4.2010

Tirazhi: 3000 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë